



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 222 Akti

Nr. 325 Vendimi
Tiranë, më 14.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 10.12.2020, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Rilinda Selimi**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila në seancën dëgjimore publike, të datës 10.12.2020, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Rilinda Selimi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe në Këshillin e Lartë të Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko. Pas dorëheqjes së paraqitur nga komisionere Valbona Sanxhaktari, dhe pranimit të kësaj kërkesë me vendimin e datës 23.11.2018, është zëvendësuar nga komisioneria zëvendësuese e këtij trupi gjykues, Etleda Çiftja, e përzgjedhur paraprakisht me short. Më pas edhe komisionere Etleda Çiftja është zëvendësuar nga komisioneri Olsi Komici, i përzgjedhur me short në datën 15.1.2019, në vijim të vendimit të datës 8.1.2019, të një tjetër trupe, që pranoi kërkesën subjektit të rivlerësimit, për përjashtimin e znj. Etleda Çiftja. Zëvendësimet e mësipërme janë kryer, veç të tjerash, bazuar në vlerësimin dhe qëndrimin sipas të cilit subjektet e rivlerësimit që kanë lidhje familjare midis tyre do të rivlerësohen nga trupa gjykues tërësisht të ndryshëm – i konkretizuar më pas me vendimin nr. 6, datë 21.1.2019, të Komisionit – nisur nga fakti që komisioneret e zëvendësuara kishin qenë pjesë e trupit gjykues i cili kishte kryer më herët rivlerësimin e bashkëshortit të subjektit Rilinda Selimi.
- iv. Trupi gjykues i lartpërmendur, pasi administroi dhe analizoi të tre raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, dhe vendimin nr. 1/1, datë 23.1.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko, gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.

- v. Me vendimin nr. 2, datë 15.1.2020, trupi gjykues – duke pasur në vëmendje vendimet nr. 6, datë 21.1.2019 dhe nr. 3, datë 8.1.2020, të Komisionit dhe në funksion të garantimit të një hetimi administrativ tërësisht të pavarur – vendosi të mos administronte materiale të dosjes së hetimit të kryer nga një tjetër trup gjykues përgjatë rivlerësimit të bashkëshortit të subjektit Rilinda Selimi, por të kryente një hetim të pavarur, të thelluar dhe gjithëpërfshirës lidhur me të gjitha faktet dhe rrethanat që do të vlerësoheshin të nevojshme për rivlerësimin e znj. Rilinda Selimi.
- vi. Në vlerësim të provave të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Rilinda Selimi, me vendimin nr. 3, datë 27.11.2020, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën e hetimit administrativ dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të çmojë që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tri kriteret e rivlerësimit, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vii. Në datën 27.11.2020, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën e barrës së provës – për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.
- viii. Subjekti i rivlerësimit, ndonëse nuk është njohur me dosjen përkatëse pranë Komisionit, ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e tij, në datën 7.12.2020, brenda afatit të caktuar, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- ix. Gjithashtu, në datën 7.12.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 10.12.2020, duke e njoftuar përmes postës elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Brakno Hrvatin, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin e Komisionit, znj. Rilinda Selimi, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacion provues përkatës.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 10.12.2020 u mbyll, për të rifilluar më 14.12.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ kryesisht.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në

analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, së bashku me argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (viii) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A. RIVLERËSIMI I KRITERIT TË PASURISË

1. Pikë tregtimi karburanti me pakicë

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë të vitit 2013, më tej, në deklaratën *Vetting* dhe zotërohet në masën 50% nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit (z. Sh. S.) dhe në masën 50% nga babai i këtij të fundit (z. K. S.).
2. Vlera e pasurisë në deklarimin e vitit 2013¹ dhe në deklaratën *Vetting*² është përshkruar në vlerën 250.000 euro, vlerë e cila përputhet me çmimin e kontratës së shitblerjes. Pasuria në fjalë ndodhet në z. k. 8602, me nr. 23-2/T dhe sip. 432 m², nga të cilat ndërtim 132.25 m², blerë sipas kontratës së shitjes me rezervë³, me vlerë të përgjithshme prej 250.000 euro⁴, shitur nga “Tirana Bank”⁵, sipas procedurave të parashikuara.

¹ Vlera e deklaruar e pasurisë 250.000 euro. Nuk deklarohet në DIPP-në e vitit 2013, qartësisht shuma e paguar për blerjen e karburantit, në rubrikën përkatëse.

² Në deklaratën *Vetting*, deklarohet se shuma e paguar është 125.000 euro. Rezulton se subjekti ka paguar një vlerë më të madhe se vlera e deklaruar, pasi ka shlyer detyrimin prej 5.140 euro për llogari të z. K. S.

³ Kontratë shitje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2013.

⁴ Nga kjo shumë janë paguar prej subjektit dhe bashkëshortit të saj si bashkëpronar të ½ pjesë , çmimi blerjes prej 125.000 euro.

⁵ Referuar praktikës së “Tirana Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2019, rezulton se pas vlerësimit të ofertave të mbëritura në “Tirana Bank”, deri në datën 23.4.2013, Bordi ekzekutiv i saj vlerësoi si ofertë fituese ofertën me vlerë 250.000 euro të depozituar nga z. K. S.

3. Burimi financiar për blerjen e kësaj pasurie është deklaruar, në deklaratën *Vetting*, nga subjekti i rivlerësimit, si vijon:
 - i. kontratë shitje apartamentim ndodhur në Vlorë, në vlerën 69.560 euro;
 - ii. kontratë shitje garazhi, ndodhur në Vlorë, në vlerën 9.500 euro;
 - iii. shitje e automjetit tip Benz Mercedes në vlerën 8.000 euro⁶;
 - iv. kursime, ndër vite, nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, të depozituara/gjendje në dy llogari bankare, respektivisht njëra në vlerën 10.000 euro në “Credins Bank” dhe tjetra në shumën 2.000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”;
 - v. kredi e marrë në “Tirana Bank”, në vlerën 6.600.000 lekë⁷.
4. Për analizimin e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni ka administruar dokumentacionin e përshkruar në vijim:
 - i. shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2018, të ASHK-së Vlorë, nëpërmjet të cilës, është konfirmuar se z. Sh. S. ka të regjistruar në bashkëpronësi me z. K. S., pasurinë e llojit truall me sip. 432 m² dhe ndërtesë me sip. 132.25 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***;
 - ii. dokumentacion lidhur me tjetërsimin e pasurisë apartament me sip. 98 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të shtetasve Sh. dhe Rilinda Selimi, i shitur⁸ me kontratën e datës 27.4.2013, në favor të z. S. A., në vlerën 69.500 euro;
 - iii. dokumentacion lidhur me tjetërsimin e pasurisë garazh me sip. 32 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të shtetasve Sh. dhe Rilinda Selimi, shitur⁹ me kontratën e datës 27.4.2013, në favor të z. S. A. me vlerë 9.500 euro;
 - iv. mandatarkëtim, datë 10.5.2013¹⁰, nga ku rezulton se është paguar në total shuma prej 190.024 euro (mandat transfertë në llogari shuma prej 89.024 euro, nga z. Sh. S. dhe mandat depozitimi në arkë me vlerë prej 101.000 euro, nga z. K. S.);
 - v. mandat depozitimi në arkë në datën 23.8.2013 i shumës prej 10.000 euro nga z. Sh. S. me përshkrim “blerje pasuri e bankës”, me burim të fondeve – deklaruar kursime familjare;
 - vi. kontratë kredie afatgjatë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2013, me “Tirana Bank”, me objekt “blerjen e truallit¹¹ me sipërfaqe 432 m²”, me kohëzgjatje të parashikuar në 10 vjet¹²;
 - vii. deklaratë noteriale¹³ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2014, e kredidhënësit “Tirana Bank”, ku deklarohet se kredia e dhënë në favor të kredimarrësve Sh. dhe Rilinda Selimi, është shlyer plotësisht – duke dhënë pëlqimin e saj, për lirim e pasurisë nga barra hipotekore;

⁶ Në “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁷ Kredi në “Tirana Bank”, disbursuar shuma 6.400.000 lekë.

⁸ Shitur në vlerën 69.500 euro.

⁹ Shitur në vlerën 9500 euro.

¹⁰ Transfertë nga z. Sh. S. të shumës prej 89.024 euro, shumë kjo e krijuar nga kreditimi prej 79.060 euro nga shitja e apartamentit dhe garazhit të ndodhur në Vlorë dhe 9.974 euro të transferuara nga subjekti i rivlerësimit. Mandat depozitimi, datë 10.5.2013, nga K. S. i shumës 101.000 euro.

¹¹ Në sipërfaqen e truallit ndodhet edhe sipërfaqja prej 132.25 m² e ndërtesës.

¹² Për garantimin e së cilës është vendosur si barrë hipotekore pika e karburantit, me Kontratën e Hipotekimit nr. *** Rep/Nr. *** Kol të datës 03.10.2013, e njëjta pasuri që ishte objekt i shit-blerjes në fjalë;

¹³ Referuar deklaratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2014, kredia e marrë është shlyer dhe për këtë është dhënë pëlqimi për lirim nga barra hipotekore, deklaruar në DIPP-në për vitin 2014 dhe në deklaratën *Vetting*, shlyer vlera prej 5.940.000 lekë.

- viii. deklaratë noteriale¹⁴ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2015, ku z. K. S. (babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), deklaroi se në vitin 2014, i ka shlyer/kthyer z. Sh. S. një shumë prej 5.140 euro¹⁵ – të cilat bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i kishte paguar më shumë kur ishte kryer blerja e pikës së karburantit në bashkëpronësi;
- ix. kontratë prenotimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.9.2006, me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., për një apartament dhe një garazh, ndodhur në Vlorë me vlerë/çmim total prej 45.000 euro;
- x. kontratë kredie¹⁶ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2008, midis z. Sh. S. dhe znj. Rilinda Selimi, si kredimarrës, me dorëzanës z. K. S. dhe znj. Xh. S., dhe kredihënës Banka Kombëtare e Greqisë, në shumën prej 20.000 euro, me afat shlyerje 5 vjet;
- xi. kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme¹⁷ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2013, të apartamentit me sipërfaqe totale 98 m², në z. k. ***, lagjja “****”, me çmim 69.000 euro¹⁸;
- xii. kontratë e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2013, garazh me sipërfaqe totale 32 m², në z. k. ***, çmimi i shitjes është 9.500 euro¹⁹.
5. Nga analizimi i dokumentacionit të sipërpërkthuar dhe vlerësimi krahasimor i përmbajtjes së tij me deklaratimet e kryera, ndër vite, si dhe në deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të sakta lidhur me veprimet juridiko-financiare në fjalë.
6. Lidhur me shlyerjen e vlerës së blerjes së kësaj pasurie, nga analiza e dokumentacionit përkatës, është konstatuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer këto pagesa:
- shuma 89.024 euro në datën 10.5.2013, e cila është akumuluar në llogari bankare si shumatore e të ardhurave: 79.060 euro, të përfituara nga shitja e apartamentit dhe e garazhit të ndodhur në Vlorë dhe shuma prej 9.964²⁰ euro e transferuar nga llogaria e përbashkët në “Credins Bank”;
 - shuma prej 10.000 euro në datën 23.8.2013, depozituar në llogarinë në “Tirana Bank” për blerje pasurie të bankës²¹;
 - shuma prej 4.922 euro në datën 18.10.2013, e cila është këmbyer nga gjendja në llogarinë që kishin në monedhën lekë;
 - shuma prej 45.077 euro në datën 25.10.2013, e cila rrjedh nga këmbimi i shumës prej 6.400.000 lekësh, e cila përkon dhe buron nga kredia e marrë në “Tirana Bank”.

¹⁴ Deklarata noteriale e deklaruar si në DIPP-në për vitin 2014 dhe në deklaratën *Vetting*, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2015, ku deklarohet nga z. K. S. në vitin 2014, i ka shlyer shumën të llogaritur prej 5.140 euro, të cilat bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar më shumë.

¹⁵ Paguar më shumë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, por nuk është deklaruar detyrimi në rubrikën përkatëse, që K. S. i ka pasur Sh. S.

¹⁶ Kredia në shumën prej 20.000 euro është marrë për blerjen e apartamentit me nr. pasurie ***, me sip. 98 m², deklaruar në DIPP-në e vitit 2008. Për marrjen e kësaj kredie është hipotekuar apartamenti me nr. pasurie ***, me sip. 57.10 m², në pronësi të K. dhe Xh. S..

¹⁷ Deklaruar në DIPP-më e vitit 2013, kontratat e shitjes së apartamentit dhe garazhit, si dhe në deklaratën *Vetting*.

¹⁸ Në kontratën e shitblerjes citohet se çmimi i paguar me transfertë bankare është 69.000 euro dhe çmimi referuar çmimit të referencës është 69.560 euro.

¹⁹ Referuar vërtetimit të “Tirana Bank”, datë 20.3.2014, rezultoi se në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në datën 6.5.2013, llogaria është kredituar në shumën 79.060.00 euro (rezultoi diferenca prej 560 euro, nga çmimi i shitjes së apartamentit).

²⁰ Nga lëvizjet bankare rezultoi se nga transfertat e shumës 9.974 euro janë mbajtur komisione bankare në shumën 9,97 euro.

²¹ Në datën 23.8.2013 rezultoi që znj. Rilinda Selimi ka tërhequr nga llogaria në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumën prej 10.269 euro, e krijuar nga të ardhurat nga shitja e automjetit tip Benz (2012 – trajtuar në pasurinë nr. 4 të këtij relacioni) dhe pjesa tjetër kursime

7. Ndërsa nga bashkëpronari tjetër në këtë pasuri, z. K. S., në datën 10.5.2013, është depozituar në llogarinë bankare të shitësit, shuma prej 101.000 euro, burimi i të cilave është analizuar nëpërmjet përlllogaritjeve të të dhënave financiare në dispozicion, pasi është konsideruar person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, dhe ka rezultuar se ka pasur burime financiare²² të mjaftueshme për kursimin e kësaj shume – siç do të trajtohet më gjerësisht më tej, në pikën 14.
8. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 5, ka kërkuar shpjegime dhe saktësime shtesë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me konstatimin se dukej se bashkëshorti i subjektit kishte paguar një vlerë më të madhe prej 24.000 euro për këtë pasuri, krahasuar me bashkëpronarin, me përgjigjet e datës 3.2.2020, subjekti ka argumentuar, si vijon:

“Bashkëpronari K. S. ka paguar shumën 101.000 euro, në datën 10.5.2013. Bashkëpronari Sh. S. ka paguar gjithsej 99.024 (nëntëdhjetë e nëntëmijë e njëzet e katër) euro (në datën 10.5.2013 ka paguar shumën prej 89.024 euro dhe më 23.8.2013 ka paguar shumën prej 10.000 euro). Pagesat e kryera nga z. K. S. dhe z. Sh. S. para lidhjes së kontratës së kredisë i përgjigjen raportit të bashkëpronësisë 1/2 pjesë secili, të vendosur që me lidhjen e kontratës së lartcitur të shitblerjes me rezervë pronësie.
9. *Gjithsej, për shkak të pagesave nga ana e qiramarrësit “***” sh.p.k., bashkëpronarët fituan të ardhura deri në datën 18 tetor 2013 në shumën 693.365 lekë. Kjo shumë u transferua nga bashkëpronari Sh. S., me pëlqimin e bashkëpronarit tjetër, për llogari të shitësit “Tirana Bank” me përshkrimin përkatës, si likuidim pjesor për pikën e karburantit. Në këtë mënyrë, me kreditimin e “Tirana Bank” të kësaj shume (693.365 lekë ose 4.922,97 euro) me burim të ardhurat e përbashkëta nga qiraja, nevoja e bashkëpronarëve për financim përmes marrjes së kredisë u pakësua dhe çmimi i papaguar ndaj shitësit “Tirana Bank” zbriti në shumën prej 45.078 euro.*
10. *Në kontratën e kredisë bashkëpronari, bashkëshorti im, Sh. S. është me cilësinë e kredimarrësit, ndërsa bashkëpronari tjetër K. S. është në cilësinë e dorëzanësit. Pavarësisht raportit të bashkëpronësisë me pjesë takuese 1/2 pjesë secili dhe të të drejtave dhe detyrimeve në masë të barabartë, përcaktimi i personit kredimarrës ishte përzgjedhje besueshmërie dhe vendosur nga kredidhënësi Tirana Bank sh.a. sipas rregullave të saj të brendshme dhe për disa arsye: (i) moshë; (ii) statusi shoqëror dhe punësimi; (iii) niveli i të ardhurave plotësisht të garantuara; (iv) marrëdhënia e posaçme mes palëve kredimarrëse (babë e bir); (v) analiza e riskut (shlyerja korrekte e një kredie të mëparshme); (vi) niveli maksimal i mjeteve garantuese të shumës së kredisë: jo vetëm nga pjesa e pronësisë së kredimarrësit por edhe nga dorëzanësi bashkëpronar në pjesë ideale. Bashkëpronarët, duke u nisur nga 1/2 pjesa takuese, ranë dakord që të ardhurat e përbashkëta nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “Petcom” sh.p.k., të kalonin në llogarinë e shlyerjes së kredisë, si detyrim i përbashkët i tyre ndaj shitësit kredidhënës”.*
11. Nga sa më lart, për më shumë qartësi mbi veprimet bankare, dhe për thjeshtimin e dinamikës së rrethanave në analizë nëpërmjet shifrave, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme kontributet respektive të dy bashkë-investuesve në fjalë.

Tabela nr. 1: kontributet e bashkë-investuesve

²² Referuar përlllogaritjeve të burimeve financiare të personit tjetër të lidhur, z. K. S., rezulton se për periudhën nga muaji prill 2006 deri në muajin prill 2013, ka realizuar të ardhura të dokumentuara me burim të ligjshëm, në masën 17.854.061 lekë.

Burimi i te ardhurave	Paguar nga Kujtim Selimi	Paguar nga Shkelzen Selimi
Derdhur nga K. S.	101,000	
Derdhur nga Sh. S. (te ardhurat nga shitja e pasurive ne Vlore)		79,060
Transferuar nga subjekti nga Credins		9,964
Kursimet Sh. S. (terhequr nga ISP - 8,000 nga makina dhe 2,000 kursime)		10,000
Te ardhura nga qiraja e perbashket (kaluar nga Petcom Shpk)		4,923
Te ardhurat nga kredia ne Tirana Bank		45,077
Kontributi	101,000	149,024

12. Ndërsa në tabelën më poshtë janë përshkruar në mënyrë të përmblendhur të gjithë zërat e investimeve, shpenzimeve dhe të ardhurave²³ të konstatuara përgjatë vitit 2013.

Tabela nr. 2: analiza financiare e vitit 2013

Përshkrimi	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Blerje pike karburanti me pakice ne Vlore	- 35,052,500
Gjendje në bankë fundi 2012	2,492,170
Gjendje në bankë 2013	- 103,931
Shpenzime gjate vitit	- 1,939,743
Pagese kredie prane NBG	- 313,790
Blerje automjet Citroen	- 420,000
Të ardhura nga punësimi te subjektit dhe bashkeshortit (te dokumentuara)	2,622,793
Përdorim i kursimeve cash	-
Kredia prane Tirana Bank	5,940,826
Te ardhura nga shitja e apartamentit ne Vlore	9,753,008
Te ardhura nga shitja e garazhit ne Vlore	1,331,995
Të ardhura nga qiraja	1,191,158
Te ardhura te tjera (dhurata/interesa)	157,479
Shuma e paguar nga K. S. per blerjen 101,000 Euro	14,161,210
Rezultati	- 179,325

13. Nga përlllogaritjet e të dhënave financiare të pasqyruara më lart, ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit, për të kryer këto pagesa në vitin 2013 – në masën e investimit të pjesës takuese të bashkëshortit të subjektit (si bashkëpronar në këtë pasuri) – dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën negative prej 179.325 lekësh.

²³ Në vitin 2013 subjekti ka deklaruar dhuratë nga motra e saj, znj. N. B., në shumën 984 euro. Pasi është pyetur subjekti në pyetësin nr. 5, në përgjigje të tij në datën 3.2.2020, subjekti ka vënë në dispozicion të ardhurat e motrës nga Agenzia delle Entrate, nga ku rezultojnë të ardhurat për periudhën 2010 – 2015 në vlerën 95.200 euro, por këto deklarata vjetore nuk rezultojnë të jenë të përkthyer, noterizuara apo me Vulë Apostile, sipas formës së kërkuar nga ligji.

1.1 Lidhur me pasuritë e paluajtshme, apartament dhe garazh – të analizuar nga Komisioni, për sa kohë të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre, janë përdorur si burim financiar për blerjen e pasurisë nr. 1 – ka rezultuar si vijon.

14. Këto pasuri janë shitur nëpërmjet kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., të pasurisë apartament me sipërfaqe totale 98 m² ndodhur në z. k. *** me numër pasurie ***, Vlorë, me çmim prej 69.560 euro dhe të garazhit, shitur me vlerë 9.500 euro. Çmimi total i blerjes së këtyre pasurive, në vlerën prej 79.060 euro, është transferuar në datën 6.5.2013, nga blerësi S. A., në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit, në “Tirana Bank”.
15. Në deklarin e pasurisë për vitin 2013, është deklaruar saktë shitja e pasurive: apartament me sip. 98 m², me çmim 69.560 euro dhe garazh me sip. 32 m², me çmim 9.500 euro.
16. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 10.10.2019, i janë kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me diferencën midis vlerës së blerjes prej tyre të këtyre pasurive dhe çmimit të shitjes, si dhe nëse ishin kryer punime apo mobilime të kësaj banese që mund të kishin ndikuar në rritjen e vlerës së saj. Nëpërmjet përgjigjeve të këtij pyetësi, subjekti është shprehur se kjo rritje çmimi ka qenë thjesht efekt i dinamikës dhe i rritjes së vlerës për shkak të kalimit të kohës dhe të koniunkturave të tregut të lirë.
17. Trupi gjykues – duke mbajtur në konsideratë: (i) kohën e kaluar midis blerjes dhe shitjes së këtyre pasurive; (ii) diferencën/rritjen e vlerës/çmimit të krahasuar me ecurinë e dinamikës së tregut të lirë; (iii) mënyrën e pagesës dhe mungesën e elementeve që mund të ngrejnjë dyshime të arsyeshme mbi çmimin real – i ka konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.
18. Gjithashtu, nga përlllogaritjet financiare të kryera nga Komisioni, kanë rezultuar të justifikuar me burime të ligjshme kursimet e realizuara nga të ardhurat prej pagave të subjektit dhe bashkëshortit, ndër vite, në vlerën 2.000 euro²⁴ të depozituara në llogaritë e tyre bankare.
19. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare ka rezultuar se në datën 23.8.2012, subjekti ka kryer një këmbim valute, nga llogaria e pagës në lekë, shumën prej 270.800 lekësh (gjendje e krijuar nga të ardhurat nga paga), në ekuivalentin e shumës prej 1.958 euro.
20. Ndërsa nga kontrata e kredisë e datës 3.9.2013, ka rezultuar se është përfituar nga “Tirana Bank”, shuma e dhënë kredi prej 6.400.000 lekësh, nga të cilat në vitin 2013 është shlyer shuma prej 459.175 lekësh dhe detyrim i mbetur prej 5.940.000 lekësh.
21. Nga analiza e të dhënave të lartpërmendura të krahasuara me deklarinet përkatëse, ka rezultuar se gjendja faktike e dokumentuar përputhet me deklarinet e kryera nga subjekti i rivlerësimit.

1.1/a Lidhur me të ardhurat që kanë mundësuar pagesën e blerjes së apartamentit dhe të garazhit²⁵

22. Në datën 18.12.2006 nga llogaria bankare e subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” ka kaluar në llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., vlera 1.000.000 lekë. Po në datën 4.10.2006, nga llogaria e përbashkët e subjektit dhe bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, është transferuar shuma prej 1.000.000 lekësh në favor të shoqërisë ndërtuese “****”

²⁴ Në “Intesa Sanpaolo Bank”.

²⁵ Thënë ndryshe: burimi i burimit financiar të përdorur për blerjen e pasurisë nr. 1.

sh.p.k. Në DIPP të vitit 2006, subjekti ka deklaruar si shumë të shlyer vlerën prej 2.000.000 lekësh, si dhe detyrimin e mbetur në shumën 28.800 euro.

23. Në tabelën e mëposhtme, është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur, shuma e investimit të kryer, të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara përgjatë vitit 2006.

Tabela nr. 3: analiza financiare e vitit 2006

Përshkrimi (viti 2006)	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Pagese pjesore per porositjen e apartamentit dhe garazhit ne 2006 nga cmimi total prej 45,000 Euro	- 2 000 000
Gjendje në bankë fundi 2005	1 371 647
Gjendje në bankë 2006	- 85 158
Shpenzime gjate vitit	- 462 350
Të ardhura nga punësimi te subjektit dhe bashkeshortit (te dokumentuara)	1 495 526
Rezultati	319 665

24. Nga deklarimi i pasurisë në vitin 2007, rezulton se subjekti ka shlyer shumën prej 8.000 euro dhe gjendja e detyrimit të pashlyer e deklaruar është në shumën 21.000 euro.
25. Në DIPP e vitit 2007, subjekti nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime në rubrikën përkatëse, si dhe nuk ka deklaruar/specifikuar burimin e të ardhurave prej 8.000 euro të shlyera në favor të shoqërisë ndërtuese.
26. Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti ka likuiduar në datën 7.1.2008, nëpërmjet transfertës bankare nga Banka Amerikane në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., shumën prej 850.000 lekësh, por subjekti e ka deklaruar këtë pagesë në DIPP të vitit 2007²⁶. Lidhur me këtë fakt, subjekti ka shpjeguar se duke qenë se deklarimi për vitin 2007 është dorëzuar në mars të vitit 2008 dhe pagesa në fjalë ishte kryer në janar të vitit 2008, subjekti e ka pasqyruar (paraprakisht) këtë shpenzim/pagesë në deklaratën për vitin 2007.
27. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare për vitin 2007 nuk evidentohen të jenë kryer pagesa për këtë shoqëri. Në shpjegimet e dhëna nga subjekti në pyetësorin nr. 2, datë 10.10.2019, evidentohet se ato janë paguar *cash* në arkën e shoqërisë – pagesë në vlerën 150.000 lekë²⁷.
28. Në datën 14.4.2008, rezulton se subjekti ka nënshkruar një kontratë kredie me NBG-në për shumën 20.000 euro me afat 5-vjeçar. Gjithashtu, është konstatuar se në datën 2.5.2008, është transferuar shuma prej 19.000 euro në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k.
29. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur: shuma e investimit të kryer, të ardhurat dhe shpenzimet gjatë vitit 2008.

Tabela nr. 4: analiza financiare e vitit 2008

²⁶ Pagesa e 150.000 lekë kryer në 2007 dhe pagesa prej 850.000 lekë paguar në datën 7.1.2008 nëpërmjet Bankës Amerikane.

²⁷ Në datat 4.5.2007, 7.9.2007 dhe 28.12.2007 i janë paguar shoqërisë “****” sh.p.k., shumat respektivisht 50.000 lekë, 40.000 lekë dhe 60.000 lekë, gjithsej shuma 150.000 lekë. Këto pagesa janë kryer nga bashkëshorti në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe janë dokumentuar me mandat pagesat përkatëse.

Përshkrimi (viti 2008)	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Pagese pjesore per blerjen e apartamentit dhe garazhit ne 2008 nga cmimi total prej 45,000 Euro	- 3 190 468
Gjendje në bankë fundi 2007	858 462
Gjendje në bankë 2008	- 472 958
Shpenzime gjate vitit	- 1 669 076
Kredi prane NBG Bank	2 135 627
Të ardhura nga punësimi te subjektit dhe bashkeshortit (te dokumentuara)	2 589 186
Rezultati	250 774

30. Nga analiza e të dhënave të mësipërme ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për të kryer pagesat e sipërcituara.

1.2 Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e pasurive apartament dhe garazh

31. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar se ka dhënë me qira apartamentin dhe një garazh për periudhën 1.9.2011 – 31.12.2011, me një vlerë totale prej 1.760 euro. Është konstatuar se në objektin e kontratës së qirasë, ndonëse përkon me deklarinimin e subjektit shifra totale e përshkruar si kundërshtëpërblim monetar për qiramarrjen në fjalë, aty nuk është specifikuar edhe përdorimi i garazhit, si send i dhënë me qira, pasi rezulton i përshkruar vetëm apartamenti.

32. Lidhur me këtë moscitim të garazhit si njëri prej sendeve të dhëna me qira, është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka shpjeguar se ky mospërshkrim ka qënë një pasaktësi e noterit publik në momentin e hartimit të kontratës së qirasë, pasi nga qiamarrësi janë gëzuar të dy sendet, pra, marrëveshja midis palëve përfshinte në këtë marrëdhënie juridike si objekt qiraje të dhëna, të dyja njësitë (apartament dhe garazh), për sa kohë garazhi në fjalë ishte një element plotësues i gëzimit dhe funksionimit të apartamentit, dokumenti bashkëngjitur kontratës në fjalë përfshinte edhe të dhënat e garazhit.

33. Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se nga shkurt i vitit 2012, pagesat e qirasë së lartpërmendur janë kryer nga qiramarrësi në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në NBG (sot ABI Bank), në masën 400 euro/muaj. Nga këto lëvizje rezulton se në datën 3.12.2012 nga kjo llogari janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja, lidhur me periudhën shtator 2011 – dhjetor 2012²⁸.

34. Gjithashtu, përgjatë vitit 2013, në këtë llogari ka vijuar të derdhet shuma e qirasë prej 2.200 euro në total deri në muajin maj, por nuk rezulton që për këto të ardhura të vitit 2013, të jenë paguar detyrimet tatimore. Nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2, edhe prej subjektit është pohuar se tatimet për këto të ardhura nuk ishin paguar, rrjedhimisht, referuar përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga Komisioni këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, është shprehur se:

²⁸ Në masën 704.8 euro, të konvertuara në 98.475 lekë.

- i. *“Lidhur me tatimin për të ardhurat nga qiraja, shpjegoj se me lidhjen e kontratës i kemi kërkuar qiramarrësit, z. A. Gj., që të kryente pagesën e tatimit për të ardhurat pranë tatimeve Vlorë, si vendi ku gjendej pasuria e paluajtshme ku banonte dhe ushtronte aktivitet tregtar.*
 - ii. *Unë kam shpjeguar në pyetësorin nr. 2, se pagimi i tatimit për periudhën shtator 2011 – dhjetor 2012, pranë organit tatimor është kryer nga qiramarrësi, sipas kërkesës sonë. Ky fakt rezultoi edhe nga shkresa kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 3.12.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë në të cilën thuhet se “referuar vlerës së kontratës dhe datës së fillimit të kontratës tatimi i paguar i korespondon periudhës shtator 2011 – dhjetor 2011” dhe se “i vetmi informacion që disponojmë është data e kryerjes së pagesës nga z. A. Gj., e cila është më 6²⁹.12.2012”.*
 - iii. *Qiramarrësi ka rënë dakord, çka rezultoi edhe nga shuma prej 400 euro/muaj që ka paguar për qiranë, ndërsa çmimi i qirasë ishte caktuar 440 euro/muaj. Komisioni ka evidentuar faktin se pagesat e qirasë janë kryer nga qiramarrësi në shumën 400 euro/muaj, në llogarinë e bashkëshortit tim në NBG Bank (sot ABI Bank). Edhe pse qiramarrësi ka shlyer si qira shumën 400 euro, në përputhje me marrëveshjen që pjesën tjetër nga çmimi i kontratës ta paguante si tatim për këto të ardhura (qiramarrësi), vetëm për periudhën janar – maj 2013 nuk e ka kryer këtë pagesë për neglizhencë dhe për këtë gjendje të mospagimit të detyrimit unë nuk kam pasur dijeni.*
 - iv. *Unë kam marrë dijeni për mospagimin e tatimit nga qiramarrësi A. Gj. gjatë procesit të rivlerësimit (pyetësori nr. 2), në sqarim të së cilit kam komunikuar me këtë shtetas. Qiramarrësi, përfundimisht më ka konfirmuar se për neglizhencë, për periudhën e fundit pesë mujore të qirasë nuk kishte kryer pagesën në organin tatimor të shumës që kishte mbajtur nga çmimi i qirasë (në burim) për këtë qëllim, sipas marrëveshjes.*
 - v. *Në këto kushte, për një përmbushje sa më të plotë të detyrimeve ligjore, ju njoftoj se shtetasi A. Gj. si qiramarrës e ka paguar diferencën e tatimit të papaguar për periudhën janar – maj 2013”.*
36. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, përveç provave që ishin administruar dhe analizuar nga Komisioni, lidhur me këtë pikë, ka paraqitur si prova të reja, si vijon:
- i. shkresë nr. *** prot., datë 3.12.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë;
 - ii. deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.12.2020, me deklarues, qiramarrësin A. Gj.;
 - iii. vërtetim bankar lëshuar në datën 5.12.2020 nga “Credins Bank” për pagesën nga qiramarrësi A. Gj. të tatimit në burim, për të ardhurat nga qiraja për periudhën janar - maj 2013, në shumën 30.706 lekë;
 - iv. urdhërpagesë, lidhur me tatimin e mbajtur në burim, datë 5.12.2020.

Vlerësimi i trupit gjykues

37. Trupi gjykues – pasi ka administruar dhe shqyrtuar provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me ligjshmërinë e burimit të shumës prej 2.200 euro, rregullisht e deklaruar nga subjekti, si e ardhur e realizuar nga qiradhënia e pasurive të lartpërmendura nga janar – maj 2013, vlerëson se, ndonëse rezultoi e provuar se: (i) pagesa e tatimit mbi këtë të ardhur është paguar nga qiramarrësi në datën 5.12.2020; (ii) edhe shlyerja e detyrimeve tatimore të mëparshme, mbi të ardhurat e viteve 2011 dhe 2012, lidhur me këtë marrëdhënie qiradhënie janë shlyer; (iii) subjekti i rivlerësimit

²⁹ Shihni aktet e pagesës bankare bashkëngjitur.

pohon se nuk ka pasur dijeni – mbi mospagimin e tatimit në fjalë, që ishte detyrim i qiramarrësit – deri në periudhën e kryerjes së hetimit administrative nga Komisioni; si dhe (iv) duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas të cilit: [pagesa e detyrimeve tatimore përgjatë hetimit administrativ (pas paraqitjes së deklaratës *Vetting*), nuk mund të legjitimojë, *post factum*, nën këndvështrimin e nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat për të cilat nuk është shlyer detyrimi financiar më herët], shuma në fjalë nuk mund të konsiderohet në analizën financiare, por rrethanat specifike të sipërcituara do të çmohen në raport me peshën dhe pasojën që mund të passjellë pamjaftueshmëria financiare e mundëshme.

1.3 Lidhur me kursimet nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, ndër vite, në vlerën 10.000 euro³⁰

38. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” konstatohet se: (i) për periudhën janar 2012 – maj 2013³¹ janë kredituar në llogari të ardhurat nga paga; (ii) në datën 3.5.2013, gjendja e akumuluar me të ardhurat nga paga, është përdorur nga subjekti, për kryerjen e një këmbimi valutor në euro, në shumën 1.336.000 lekë, ekuivalent me 9.475 euro, si dhe është depozituar *cash* shuma prej 600 euro; (iii) në po të njëjtën ditë, nga llogaria e subjektit në “Credins Bank” është transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank”, shuma prej 10.000 euro.

39. Duke konsideruar se burimet e shumave të derdhura në llogarinë e subjektit kanë rezultuar me burime të ligjshme, është konstatuar se subjekti subjekti i rivlerësimit, ka pasur burime financiare të ligjshme dhe mundësi kursimi që të krijonte këtë gjendje në llogarinë bankare nga të ardhura të ligjshme që rridhnin nga pagat e punës dhe të transferuara në vijimësi aty.

1.4 Lidhur me kredinë e marrë për shlyerjen e detyrimit për blerjen e pasurisë së pikës së shitjes së karburantit me pakicë

40. Përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se si burim i pjesshëm për blerjen e pasurisë nr. 1, është përdorur një shumë e përfutur nga një kredi e marrë në “Tirana Bank” në vlerën 6.400.000 lekë³². Nga kontrata e kredisë afatgjatë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2013, rezulton se subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit i është miratuar një kredi në “Tirana Bank”, në vlerën 6.600.000 lekë. Qëllimi i marrjes së kësaj kredie, sipas kontratës është blerja e pasurisë truall me sip. 432 m² nga e cila 132.25 m² ndërtesë. Në datën 25.10.2013 nga banka është disbursuar shuma 6.400.000 lekë. Në po të njëjtën ditë nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank” është përdorur, për kryerjen e një këmbimi valutor në euro, shuma prej 6.346.982 lekësh, në euro, të cilat janë paguar menjëherë në favor të “Tirana Bank” për likuidimin e vlerës së pasurisë së mësipërme. Kredia në fjalë është likuiduar brenda vitit 2014 duke përdorur si burim të ardhurat e realizuara nga qiraja e kësaj pasurie, si dhe disa të ardhura të bashkëpronarëve.

41. Ndërkohë, lidhur me ekuilibrin financiar midis dy bashkinvestuesve në pasurinë nr. 1, ka rezultuar se bashkëpronari K. S., në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2015, ka deklaruar se: “... në vitin 2014 i detyrohej të birit, Sh. S. 5.140 euro³³,

³⁰ Në “Credins Bank”.

³¹ Veprime të cilat kanë vijuar edhe pas kësaj periudhe.

³² Kredia në “Tirana Bank” është miratuar fillimisht në shumën 6.600.000 lekë, por është disbursuar 6.400.000 lekë, pasi janë zbritur shpenzimet administrative dhe të asiguracionit përkatës.

³³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 3.2.2020, subjekti sqaron këtë diferencë të krijuar prej 5.140 euro: nga detyrimi total për mbylljen e kredisë në “Tirana Bank” 6.780.810 lekë janë zbritur të ardhurat e përbashkëta nga qiraja prej 5.276.354 lekë dhe ka rezultuar pjesa e mbetur e kredisë mbyllur me të ardhurat e z. Shkëlzen Selimi e barabartë me 1.504.456 lekë. $1.504.456 \text{ lekë} / 2 = 752.228 \text{ lekë}$ (ekuivalenti i 5.140

të cilat (i biri) i kishte paguar (më shumë) nga të ardhurat e tij për shlyerjen e kredisë”.
*“Për shlyerjen e këtij detyrimi ai ka deklaruar se ka derdhur në llogarinë e z. Sh. S. shumën prej 90.000 lekë, në muajin nëntor 2014 dhe pjesa tjetër prej 4.500 euro është kompensuar përmes shumës së paguar nga qiradhënësi, shoqëria “***” sh.p.k.”.*

42. Për sa më lart është konfirmuar nga të dhënat e dokumentacionit të administruar dhe shqyrtuar nga Komisioni.
43. Nisur nga sa është konstatuar lidhur me çdo burim të përdorur për blerjen e pjesës takuese të pasurisë nr. 1, të analizuar në pikat e mësipërme, në një vlerësim të përgjithshëm dhe konkluziv të kësaj pasurie ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën negative prej 179.325 lekësh.

1.5 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira pikën e shitjes me pakicë të karburantit

44. Gjithashtu, nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se bashkëpronarët Kujtim dhe Sh. S. kanë dhënë me qira pikën e shitjes me pakicë të karburantit në fjalë, përgjatë segmenteve kohore të përshkruara në vijim:
- i. Kontratë qiraje³⁴ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2013, midis Sh. dhe K. S., me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.a., me afat 2 vjet, me qira mujore të përlllogaritur në bazë të fitimit mujor³⁵. Kjo kontratë është revokuar me dokumentin, revokim kontrate qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.2014.
 - ii. Kontratë qiraje³⁶ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.10.2014, midis Sh. S. dhe K. S., me shoqërinë “****” sh.p.k., për dhënien me qira të truallit dhe godinës së pikës së karburantit dhe mjeteve të tjera ndihmëse, me afat 1.10.2014 – 1.10.2024, me qira shumën 10.000 euro/muaj³⁷. Kjo kontratë është revokuar me dokumentin revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2015.
 - iii. Kontratë qiraje³⁸ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.6.2015, midis qiradhënëseve Sh. S. dhe K. S. dhe qiramarrësit “****”, me afat nga 1.6. 2015 – 31.5.2020, me qira në shumën 10.000 euro/muaj, i cili do të paguajë taksat dhe detyrimet e parashikuara, tatimin në burim, energjinë dhe ujin.

Euro, shuma e paguar tepër nga Sh. S.). Detyrimi i bashkëpronarit K. S. i shlyer prej tij (90.000 lekë + 4.500 euro) është deklaruar e ardhur nga bashkëshorti në shumën e llogaritur prej 5.140 euro, në deklaratën e pasurisë depozituar pranë ILDKPKI-së për vitin 2014. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se nuk ka më detyrime financiare midis tyre, konfirmuar kjo edhe me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë 16.3.2015.

³⁴ Sipas deklaratës *Vetting*, për këtë periudhë qiraja neto është llogaritur në bazë të fitimit neto të realizuar nga 2 shoqëritë qiramarrëse, “****” dhe “****”, ku 90% te të ardhurave neto mujore i ka marre qiradhënësi dhe 10 % i ka marre qiramarrësi, mbasi janë paguar detyrimet fiskale. Kjo qira është paguar në “Tirana Bank” dhe është përdorur për shlyerjen e kredisë së pikës së karburantit. Duket se nuk përputhet deklarimi për shumën e të ardhurave, pasi deklaroi 995.663 në DIPP 2014, me shoqërinë “****”, si dhe ka mospërputhje të datave të nënshkrimit të kontratës, referoju DIPP 2014, faqe 4.

³⁵ Me vërtetimin, datë 1.6.2018, D. L. në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., ka informuar se në vitin 2013 ka lidhur kontratën e qirasë me shtetasit K. dhe Sh. S. për marrjen me qira të pikës së karburantit në Vlorë. Ai ka bashkëngjitur pasqyrën e rezultatit financiar të pikes së karburantit në Vlorë, sipas të cilës, gjatë periudhës së qirasë (29.7.2013 – 31.12.2013) ka realizuar të ardhura në masën 25.083.467 lekë dhe fitim neto në masën 1.830.681 lekë, nga e cila 90% ishte pjesa e qiradhënësit. Pas mbajtjes së tatimit në burim, qiradhënësit i ka kaluar shuma e qirasë prej 1.482.852 lekë. Kjo shumë përputhet me shumën totale të transferuar në llogarinë bankare të Sh. S. dhe K. S. në vitet 2013 dhe 2014.

³⁶ Deklaruar në DIPP të vitit 2014, si të ardhura *neto* të fituara nga dhënia me qira e pronës, për pjesën e subjektit dhe të bashkëshortit në ½ si bashkëpronar, për periudhën 1.1.2014 – 30.9.2014, nga shoqëria “****” sh.p.k. me vlerë 13.500 euro.

³⁷ Kjo pagesë është bërë në llogarinë e bashkëshortit në “Tirana Bank”, dhe sipas kontratës dy muajt e parë do të parapaguheshin nga qiramarrësi. Në DIPP 2014, subjekti ka deklaruar të ardhurat neto në shumën 13.500 euro, pas mbajtjes së tatimit në burim prej 10% nga qiramarrësi. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura mujore nga kjo kontratë në vlerën 4.250 euro, e cila përputhet me pjesën e bashkëshortit gjatë vitit 2015, pas mbajtjes së tatimit në burim prej 15%.

³⁸ Deklaruar në DIPP-në e vitit 2015, si të ardhura *neto* nga dhënia e qirasë për pjesën e bashkëshortit në ½ si bashkëpronar, për periudhën 1.6.2015 – 31.12.2015, nga shoqëria “****” sh.p.k., vlera prej 29.750 euro. Në deklaratën *Vetting* janë deklaruar të ardhurat nga kjo kontratë në masën 8.500 euro në muaj, nga të cilat 4.250 euro janë pjesa e subjektit dhe bashkëshortit.

45. Përgjatë hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e një hetimi të thelluar dhe gjithëpërfshirës, Komisioni i është drejtuar me shkresën nr. *** prot, datë 30.10.2019, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe me shkresën nr. ***, datë 30.10.2019, Drejtorisë Rajonale Durrës, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me pagimin e detyrimit tatimor për të ardhurat nga qiradhënia e pasurisë në analizë, si dhe e pasurive të tjera, në pronësi ekskluzive të z. K. S., të dhëna me qira më herët prej tij – përpara blerjes (të pjesës takuese 50%) së pasurisë nr. 1.
46. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 14.11.2019, DPT-ja ka përcjellë informacionin e kërkuar, lidhur me subjektet “***”, “***”, dhe “***”. Gjithashtu, DRT-ja Durrës, me shkresën nr. ***prot., datë 11.11.2019, ka vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e disponueshëm lidhur me pagimin e detyrimeve nga shoqëritë “***”, “***” dhe “***”.
47. Nisur nga konstatimi i ndryshimit të çmimit të qirasë nga kontrata e parë në vitin 2013, lidhur me shoqëritë “***” dhe “***”, krahasuar me kontratat e mëpasshme të qirasë me shoqëritë “***” sh.p.k., dhe “***” sh.p.k., Komisioni i është drejtuar edhe DRT-së Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2020, për të administruar të dhëna mbi qarkullimin/fitimin apo humbjen e mundëshme, të deklaruar nga shoqëritë “***” sh.p.k., dhe “***” sh.p.k., lidhur vetëm me aktivitetin e pikës së karburantit me vendndodhje në Vlorë, pra, për pasurinë nr. ***, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit me babanë e tij.
48. DRT-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2020, ka informuar se shoqëria “***” sh.p.k., është nën administrimin e DRT-së Tiranë, ndërsa shoqëria “***” sh.p.k. është nën administrimin e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.
49. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2020, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2020, ka bërë me dije se tatimpaguesit deklarojnë dhe paguajnë tatimet për të gjithë veprimtarinë ekonomike të përgjithshme që kryejnë në nivel vendi dhe jo për çdo adresë në veçanti, si dhe ka vënë në dispozicion të ardhurat dhe fitimet e realizuara nga shoqëria “***” sh.p.k. në total, ndër vite, nga ku konstatohet se në vitin 2015, kjo shoqëri ka realizuar në total një qarkullim në shumën prej 245.361.018 lekësh dhe një fitim *neto* në shumën prej 4.140.084 lekësh.
50. Ndërsa, DRT-ja Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2020, për shoqërinë “A***” sh.p.k., ka informuar mbi qarkullimin dhe fitimet e përgjithshme të saj ndër vite. Në vitin 2014 kjo shoqëri ka realizuar në total një qarkullim prej 254.111.963 lekësh dhe fitim *neto* në vlerën 4.251.567 lekë, ndërsa për vitin 2015 ka realizuar një qarkullim në vlerën 127.260.247 lekësh dhe fitim *neto* në vlerën 148.849 lekë, të cilat i përkasin të gjithë aktivitetit tregtar të shoqërisë në nivel vendi, duke mos ekzistuar mundësia për të përcaktuar dhe specifikuar këto të dhëna vetëm për pikën e shitjes me pakicë të karburantit në fjalë.
51. Nisur nga informacionet e administruara, si më sipër, konstatohet se nga Komisioni nuk mund të kryhet një analizë specifike për pikën e karburantit në Vlorë, për sa kohë të dhënat e vëna në dispozicion nga drejtoritë përkatëse të tatimeve përfshijnë të gjithë aktivitetin e shoqërive. Megjithatë, nga krahasimi i fitimeve totale të këtyre shoqërive qiramarrëse për periudhat gjatë së cilave kanë pasur pasurinë në fjalë me qira, ka

rezultuar se shoqëritë në fjalë kanë pasur aktivitet tregtar/ekonomik me të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme për të përballuar pagesën e qirasë³⁹.

52. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shlyer detyrimin e mbetur nga kredia e marrë në “Tirana Bank”, në vlerën 5.940.000 lekë, me të ardhurat nga qiraja e pikës së karburantit – të deklaruara, ndër vite, në DIPP-të përkatëse – dhe nga të ardhurat personale.
53. Pas verifikimeve dhe përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni, ka rezultuar se këto të ardhura, përkojnë specifikisht me deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të vitit 2014, të cilat kanë shërbyer si burim financiar i ligjshëm për shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj bankës kredidhënëse.
54. Për rrjedhojë, Komisioni ka konstatuar se në deklaratën e pasurisë së vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të ardhurat nga dhënia me qira e pikës së karburantit, të cilat kanë përbërë burim financiar të ligjshëm dhe të mjaftueshëm për pagesat e kryera përgjatë atij viti.

2. Lidhur me automjetin tip “Fiat”, me targa ***

55. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në DIPP-në e vitit 2003, nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar pronësia e automjetit tip “Fiat”, me targa ***, në vlerën 600.000 lekë, ndërkohë që në kontratën e shitjes⁴⁰, datë 1.10.2003, çmimi i blerjes së këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit është përshkruar në shumën prej 250.000 lekësh. Më pas, ky automjet është shitur me kontratën⁴¹ e datës 9.7.2011, në vlerën prej 5.000 euro (ose rreth 691.500 lekë⁴²).
56. Nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 18.10.2019, lidhur me shkakun e mospërpunues së të dhënave të kontratës me atë të deklaratimit, për sa i përket vlerës së shitjes, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Vlera e blerjes ka qënë 250.000 lekë dhe se ka qënë një gabim në shkrimin e kësaj vlere, pasi ky ka qënë një çmim preferencial nga ana e shitësit për shkak të njohjeve familjare, si dhe këtij mjeti nuk i janë bërë shpenzime të tjera shtesë”*.
57. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit – nëpërmjet prapësimeve të paraqitura me shkrim, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe me shpjegimet e dhëna përgjatë seancës dëgjimore – ka përshkruar dy rrethana specifike, për të cilat shitësi i automjetit në fjalë dhe, njëkohësisht, kushëri i bashkëshortit, ta kalonte mjetin në favor dhe në emër të subjektit me një çmim më të ulët se ai real i tregut dhe konkretisht: (i) kalimi i pronësisë së mjetit ishte kryer shumë afër lidhjes së martesës midis subjektit dhe bashkëshortit dhe, kështu, trajtimi preferencial në çmimin e shitjes konsiderohet si një dhuratë për martesën e kushëririt të shitësit; (ii) gjithashtu, nëpërmjet aplikimit të këtij çmimi, shitësi në mënyrë indirekte kompensonte dhe shprehte mirënjohjen e tij lidhur me faktin që vëllai i bashkëshortit të subjektit për shumë kohë kishte mbajtur me shpenzimet e tij, në shtëpinë e tij në Itali, shitësin e mjetit në fjalë.
58. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga diferenca shtesë midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes, subjekti ka bërë me dije se nuk ka pasur

³⁹ Kjo shoqëri rezultoi të jetë regjistruar në datën 24.7.2013 dhe gjatë aktivitetit të rreth 5 muajve ka realizuar një fitim *neto* prej 1.795.016 lekësh, referuar bilancit të publikuar nga kjo shoqëri në faqen e web-it të QKB, www.qkb.gov.al. Duke konsideruar që fitimi për periudhën 5 mujore ka qënë 1.795.016 lekë, me një analizë të thjeshtë përpjestimore, për të gjithë vitin do të rezultonte një fitim *neto* prej 4.308.038 lekësh.

⁴⁰ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.10.2003, me vlerë 250.000 lekë.

⁴¹ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.7.2011, shitur me vlerë 5.000 euro.

⁴² Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2011, ku 1 euro këmbëhej me 138.3 lekë.

asnjë detyrim për të paguar, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

59. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, rezulton se ka qënë detyrimi i subjektit të rivlerësimit të paguante tatimin mbi diferencën e të ardhurave të përfituara nga shitja e këtij automjeti, pasi të zbritej shuma e shpenzuar për blerjen dhe posedimin e tij. Neni 7, pika 1, e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, parashikon se individët (rezidentë) i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu. Pra, nëse konsiderohet se nga shitja e kësaj pasurie ka pasur fitime shtesë – fitim të shtuar mbi çmimin e blerjes – atëherë individi përfitues i kësaj të ardhure duhet të kishte pagur detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale, të përfituar shtesë.
60. Nisur nga situatat dhe rrethanat faktiko-ligjore të lartpërmendura, trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri çmon se:
- i. Shpjegimet e subjektit rezultojnë bindëse vetëm për sa i përket faktit se blerja e mjetit nga një person i afërt, në marrëdhënie dhe rrethana të veçanta, justifikon aplikimin e një çmimi për këtë mjet, më të ulët se ai i tregut. Në çdo rast, nisur nga fakti që nuk është konstatuar ndonjë shqyrtim çështje gjyqësore në konflikt interesi, nga subjekti, me palë shitësin e mjetit në fjalë, pasaktësia në deklarinimin vjetor të vlerës së autoveturës, nuk mund të passjellë ndonjë pasojë penalizuese për subjektin e rivlerësimit, veç moskonsiderimit të fitimit shtesë në momentin e shitjes (si në vijim).
 - ii. Fitimi i realizuar nga shitja e këtij mjeti, për sa i takon diferencës së vlerës së shtuar, në shumën prej 441.500 lekësh, për sa kohë nuk rezulton i paguar tatimi mbi fitimin dhe referuar përcaktimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të konsiderohet si një e ardhur financiare me burim të ligjshëm dhe, për rrjedhojë, as nuk është përfshirë në analizën përkatëse financiare si një burim monetar i ligjshëm.

3. Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”

61. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2012, ka shitur autoveturën tip “Mercedes Benz”, me targa ***, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.8.2012, me vlerën 8.000 euro (ekuivalent me 1.117.760 lekë⁴³).
62. Gjithashtu, ka rezultuar se automjeti i mësipërm është blerë nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2011, kundrejt çmimit prej 900.000 lekësh.
63. Lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj blerjeje, Komisioni ka kryer përlllogaritjet përkatëse dhe për mundësuar këtë vlerësim, më poshtë është përgatitur një tabelë përmbledhëse për sa i përket vitit 2011, duke konsideruar shumën e investimit të kryer për blerjen e automjetit në fjalë, të ardhurat⁴⁴ dhe shpenzimet, deri në momentin e blerjes së automjetit, nga ku ka rezultuar një mungesë financiare në shumën prej 386.173 lekësh.

Tabela nr 5: burimet e përdorura për blerjen e automjetit

⁴³ Konvertuar me kursin e këmbimit mesatar të fundit të vitit (sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë 1 euro = 139.72 lekë).

⁴⁴ Në vijim të rezultatit lartcituat në pasurinë nr. 3, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Fiat” të subjektit të rivlerësimit, janë konsideruar si burim në analizën e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në shumën e barabartë me çmimin e blerjes prej 250.000 lekë, për sa kohë nuk janë paguar detyrimet tatimore.

Përshkrimi (viti 2011)	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Blere Automjet Tip Benz	- 900 000
Shpenzime jetese/kredie/udhetimi	- 769 173
Te ardhura nga shitja e automjetit Fiat	250 000
Fonde te terhequra nga llogarite bankare te subjektit dhe te bashkeshortit	1 033 000
Rezultati	- 386 173

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit.

64. Subjekti i rivlerësimit, pasi është pyetur me pyetësorin nr. 2, datë 10.10.2019, lidhur me kryerjen e riparimeve, të mundshme, shtesë për këtë automjet – veprim që mund të kishte çuar/ndikuar në rritjen e vlerës së mjetit – ka sqaruar se janë kryer përmirësime dhe se nuk disponon dokumentacionin përkatës dhe se vlera e shitjes në vitin 2012, ka qenë dakordësuar si vlerë tregu me shitësin.
65. Gjithashtu, subjekti është pyetur nëse ishte paguar tatimi mbi të ardhurat e realizuara në shumën 217.760 lekë (1.117.760 - 900.000), si diferencë mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se nuk ka pasur detyrim të paguajë tatim për fitimin e realizuar, pasi ky detyrim nuk ishte parashikuar nga ligji.
66. Po ashtu, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në analizën e kryer nga Komisioni në lidhje me blerjen e këtij automjeti, burimi i përdorur për blerjen e tij është i ditur, i ligjshëm dhe i matshëm, por për shkak të dispozitave ligjore të mëvonshme të cilat duket se kanë efekt prapaveprues, siç është edhe legjislacioni për rivlerësimin kalimtar, e krijojnë situatën në dukje të mungesës së burimeve të ligjshme. Edhe në lidhje me këtë automjet çmimi i shitjes është produkt i marrëveshjes së arritur mes palëve, në kushte normale tregu, në pikëtakimin ofertë-kërkesë. Shitja e automjetit nuk është bërë me qëllim fitimin apo me një çmim fiktiv. Ligji i kohës “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk ka pasur detyrime specifike për tatimin e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve të përdorimit personal dhe se nuk kam qenë subjekt që mbartja detyrimin për plotësim të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave dhe pagimin e tyre.
67. Në konkluzion, subjekti ka paraqitur një analizë financiare për vitin 2011, nga ku, duke konsideruar të ligjshme të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit tip “Fiat”, sipas saj në përputhje me legjislacionin e kohës, ka rezultuar se kishte mundësi për blerjen e automjetit të ri në vitin 2011.

Vlerësimi i trupit gjykues

68. Nisur nga sa më lart, trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri çmon se:
- i. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, qëndrimi i Komisionit, lidhur me detyrimin për pagimin e tatimit mbi fitimin e shtuar, është sqaruar më sipër (lidhur me pasurinë nr. 3, në paragrafet 58 – 59).
 - ii. Për pasojë e moskonsiderimit si një burim i ligjshëm financiar i të ardhurave shtesë të realizuara nga shitja, po në vitin 2011, të automjetit tip “Fiat” – që sipas subjektit janë përdorur si një burim i pjesshëm për blerjen e autoveturës

në analizë – rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, në vlerën 386.173 lekë⁴⁵.

4. Automjet i markës “Citroen, Tipi C3”, viti i prodhimit 2010

69. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se zotëron 50% të këtij automjeti, të blerë me kursimet nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit, ndërsa në deklarinimin e pasurisë për vitin 2013, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti me çmim 420.000 lekë, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.7.2013, në të cilën citohet se pagesa është kryer dorazi jashtë zyrës noteriale.
70. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare evidentohet se për periudhën 1.1.2013 – 15.7.2013⁴⁶, subjekti dhe bashkëshorti kanë tërhequr *cash* nga llogaritë bankare shumë prej 1.124.000 lekësh dhe kanë depozituar 600⁴⁷ euro (ekuivalent i rreth 84.126 lekë). Në deklarinimin e pasurisë për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje të kursimeve *cash* në banesë.
71. Pas përllogaritjes së shpenzimeve përgjatë periudhës 6-mujore të vitit 2013, prej 724.401⁴⁸ lekësh, mund të konkludohet se subjekti dhe bashkëshorti në datën 15.7.2013 kanë pasur mundësi për të disponuar shumë prej 420.000 lekësh, për sa kohë ka rezultuar një mungesë minimale e papërfillshme e burimeve të ligjshme financiare, prej - 20.401 lekësh.

5. Depozitë bankare në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 1.400.000 lekë

72. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në “Credins Bank” në emër të bashkëshortit në vlerën 1.400.000 lekë, me burim të krijimit nga “...kursime, ndër vite, nga të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortit”.
73. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruar nga Komisioni është konstatuar se llogaria me numër *** në “Credins Bank”, në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur një gjendje shumë prej 1.400.000 lekësh. Gjendja në këtë llogari, sipas veprimeve bankare, rezulton të jetë krijuar në shumën 1.200.000⁴⁹ lekë të mbartura nga viti 2016 dhe një urdhërxhirim në shumën 200.000 lekë në datën 17.1.2017.
74. Nga analizimi i të dhënave bankare, ka rezultuar se depozita në shumën 1.200.000 lekë në datën 2.3.2016, rezulton e krijuar nga të ardhurat nga pagat në “Credins Bank” dhe “Tirana Bank”. Nga kjo e fundit në datë 1.3.2016 është transferuar shuma 975.000 lekë për krijimin e kësaj depozite.
75. Nga sa më lart ka rezultuar se përkojnë deklarinimet e kryera në mënyrë të saktë në deklaratën *Vetting* lidhur me gjendjen e kësaj llogarie në shumën 1.400.000 lekë, dhe nuk janë konstatuar mungesa të burimeve financiare për krijimin e saj, për sa kohë ato rrjedhin nga kursimet nga pagat, të konsideruara të mjaftueshme pas analizës financiare.

6. Depozitë bankare në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortit të subjektit, në shumën 39.000 euro

⁴⁵ Kjo analizë ka marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet deri në datën e kryerjes së transaksionit në datën 26.7.2011, ndërkohë që analiza financiare e vitit rezulton me një balancë negative më të ulët, për shkak të konsiderimit në të edhe të të ardhurave të tjera gjatë pjesës tjetër të vitit.

⁴⁶ Momenti i blerjes së automjetit.

⁴⁷ Shuma 2.200 euro në llogarinë në NBG Bank janë pagesa e qirasë të derdhura nga qiramarrësi A. Gj.

⁴⁸ Përfshirë depozitimin e kryer prej 600 euro nga subjekti i rivlerësimit. Në përllogaritje të shpenzimeve janë konsideruar shpenzimet jetike, shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e udhëtimit, pasi janë zbritur pagesat e dy biletave të paguara nga motra e subjektit gjatë kësaj periudhe.

⁴⁹ Gjendje në datën 31.12.2016.

76. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar një depozitë bankare në “Credins Bank” në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në vlerën prej 39.000 euro. Burimi i krijimit të kësaj depozite është deklaruar “... të ardhurat e qirave mujore të pjesës takuese si bashkëpronar i pikës së karburantit ...”.
77. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruar nga Komisioni është konstatuar se llogaria në fjalë, me numër *** në “Credins Bank”, në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur një gjendje në vlerën 39.000 euro – aq sa dhe është deklaruar.
78. Kjo depozitë është krijuar në datën 4.3.2016, nga transferimi i shumës prej 39.000 euro nga një tjetër llogari në emër të tij, dhe me numër ***, po në “Credins Bank”, me përshkrimin “*kalim në depozitë 12-mujore*”.
79. Shuma prej 39.000 euro, e llogarisë *** në “Credins Bank” është krijuar nëpërmjet transferimit bankar të datës 1.3.2016 nga llogaria numër *** në “Tirana Bank”, po në emër të bashkëshortit të subjektit. Burimi i krijimit të kësaj shume është konstatuar të kenë qenë të ardhurat nga qiradhënia e pasurisë nr. 1, përgjatë vitit 2015.
80. Në deklarin e pasurisë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë ndryshim të gjendjes së kësaj llogarie prej 39.000 euro⁵⁰, por në DIPP të vitit 2015, është deklaruar në mënyrë të saktë depozita në “Tirana Bank”, në vlerën 39.097 euro⁵¹, me burim nga të ardhurat nga qiradhënia e pikës së shitjes së karburantit me pakicë. Gjithashtu, kjo depozitë është deklaruar në deklaratën *Vetting*, në emër të bashkëshortit me burim të ardhurash nga qiraja mujore e pjesës takuese si bashkëpronar i pikës së shitjes së karburantit me pakicë.
81. Nisur nga sa më sipër dhe në vijim të analizimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se deklarinet lidhur me gjendjen dhe burimin e kësaj llogarie bankare janë kryer në mënyrë të saktë dhe nuk kanë rezultuar pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për krijimin e saj.

7. Llogari e përbashkët bankare në “Societe Generale Albania” (sot OTP Bank), në emër të bashkëpronarëve K. dhe Sh. S., në vlerën 41 euro. Pjesa takuese: 50%.

82. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioni, është konstatuar se llogaria e përbashkët në emër të Sh. dhe K. S. – me numër ***– në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur gjendje rreth 48 euro.
83. Në vijim të analizës së veprimeve bankare të kryera në këtë llogari, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka kaluar nga kjo llogari, në llogarinë personale në OTP Bank, shumën 8.510 euro, përgjatë vitit 2015 dhe shumën 51.000 euro përgjatë vitit 2016, aq sa është deklaruar saktësisht edhe në DIPP-të përkatëse.
84. Për rrjedhojë, ka rezultuar se përkojnë deklarinet e kryera lidhur me gjendjen e kësaj llogarie dhe nuk ka rezultuar ndonjë mungesë e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e saj.

8. Llogari bankare personale në “Societe Generale Albania” (sot OTP Bank), në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 72.272 euro. Pjesa takuese: 50 %.

⁵⁰ Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar kursime nga të ardhurat nga qiraja e pikës së karburantit vlerën prej 51.000 euro, në “Societe Generale Albania”.

⁵¹ Nga e cila rrjedh depozita në analizë.

85. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar një depozitë bankare “Societe Generale Albania” (sot OTP Bank), në emër të bashkëshortit, në vlerën 72.272.85 euro. Burimi i krijimit të kësaj depozite është përshkruar: “...të ardhurat e qirave mujore të pjesës takuese si bashkëpronar i pikës së karburantit...”.
86. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioni, është konstatuar se llogaria në emër të z. Sh. S. me numër klient *** në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur një gjendje në vlerën 72.272.85 euro – siç është deklaruar saktësisht nga subjekti. Gjithashtu, ka rezultuar se akumulimi i kësaj gjendje fillon në vitin 2015 dhe, në vijim, ku janë kredituar të ardhurat nga kontrata e qiradhënies së pasurisë nr. 1. Subjekti ka deklaruar rregullisht gjendjet e kësaj llogarie duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2015, në shumën 8.510 euro dhe në DIPP-në e vitit 2016, në shumën 51.000 euro.
87. Nga sa më lart, ka rezultuar se deklaratimet e kryera nga subjekti, nga DIPP-ja e vitit 2015 deri në deklaratën *Vetting* (përfshirë), përputhen me gjendjen dhe burimet e krijimit të kësaj llogarie bankare, përkojnë me dokumentacionin bankar të administruar dhe nuk ka rezultuar ndonjë mungesë e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e saj.
- 9. Llogari bankare rrjedhëse në “Credins Bank”,** në emër të vajzës së subjektit, J. S., në shumën 27.000 lekë, çelur nga Bashkia Tiranë si nxënës me rezultate të shkëlqyera dhe **llogari bankare rrjedhëse “Credins Bank”,** në emër të djalit të subjektit, L. S., në shumën 27.000 lekë, çelur nga Bashkia Tiranë si nxënës me rezultate të shkëlqyera.
88. Lidhur me dy llogaritë e mësipërme, nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioni, ka rezultuar se konfirmohet shuma e gjendjeve në total 54.000 lekë, si dhe burimi i deklaruar saktë nga subjekti, dhe nuk ka dyshime mbi burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.
- 10. Llogari rrjedhëse e pagës në “Raiffeisen Bank”,** në emër të subjektit të rivlerësimit në shumën 5.132.79 lekë dhe **llogari rrjedhëse e pagës në “Credins Bank”,** në emër të bashkëshortit në vlerën 297.93 lekë.
89. Lidhur me dy llogaritë e lartpërmendura, nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të administruar nga Komisioni, konfirmohet shuma totale e dy llogarive të deklaruara saktë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe krijimi i gjendjeve të tyre me burime të ligjshme financiare.
- 11. Depozitë si Garanci Bankare për marrje kartë krediti në “Tirana Bank”,** në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 3.900 euro.
90. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioni konfirmohet shuma e deklaruar si gjendje në depozitën me numër *** në “Tirana Bank”, si dhe rezulton se është kaluar nga llogaria *** në euro e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, datë 15.4.2015, si garanci bankare për marrjen e një karte krediti.
91. Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar saktë krijimin e kësaj depozite në deklaratimin e pasurisë për vitin 2015, si dhe burimi financiar për krijimin e të cilës mbulohet nga burime të ligjshme financiare, sipas analizës financiare, ndonëse nuk është specifikuar.

12. REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

92. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të

ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre, është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

93. Lidhur me analizën financiare të Komisionit, në bazë të së cilës, në momentin e mbylljes së hetimit administrativ “*ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën 505.705 lekë*”, subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, veç pretendimeve lidhur me të ardhurat e viteve 2011 dhe 2013 – që janë trajtuar përgjatë analizave të burimeve të pasurive përkatëse (nr. 3 dhe nr. 1) – ka kundërshtuar analizën financiare edhe për vitin 2015, duke shpjeguar se të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pikës së karburantit për këtë vit kanë qenë 51.000 euro dhe jo 42.500 euro, siç janë konsideruar dhe përlllogaritur nga Komisioni.
94. Konkretisht, subjekti është shprehur se nga rishikimi në tërësi i analizës financiare, përveç çështjeve të trajtuara më sipër, për vitin 2015 evidentohet që ka mungesë të burimit të të ardhurave në vlerën -208.382 lekë për mbulimin e shpenzimeve dhe të kursimeve. Nga shqyrtimi me kujdes i të gjithë kësaj analize ka evidentuar se ka një pasaktësi në përlllogaritjen e të ardhurave nga qiraja e pikës së karburantit të cilat janë llogaritur në vlerën 42.500 euro, kur në fakt janë 51.000 euro, referuar lëvizjeve bankare në “Tirana Bank” dhe “OTP Bank” për vitin 2015.
95. Lidhur me sa më lart është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se realisht pjesa takuese e të ardhurave për vitin 2015, nga dhënia me qira e pikës së shitjes me pakicë të karburantit, duke konsideruar gjendjet si në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank” dhe në llogarinë tjetër dyemërore, të përbashkët midis tij dhe babait të tij, në “OTP Bank”, rezultojnë të jenë transferuar në total shumat prej 51.000 euro, por nga kjo shumë totale, vetëm 42.500 euro janë transferuar dhe disponuar në llogarinë personale të bashkëshortit përgjatë vitit 2015, ndërsa pjesa tjetër ka qëndruar në llogarinë e përbashkët (dhe janë transferuar më pas tek ai, në vitin 2016). Për shkak të një zgjedhje teknike të bërë nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, me qëllim evitimin e dublikimit të shifrave hyrëse si të ardhura vjetore, që shpesh rezultonin si hyrje në dy llogaritë komunikuese – (fillimisht nga qiramarrësi të llogaria e përbashkët, dhe më pas pjesa takuese e secilit transferohej në llogaritë respektive), gjendjet e llogarisë së përbashkët nuk janë përfshirë në analizën e likuiditeteve totale. Në këto kushte, ndonëse e ardhura e disponuar gjatë vitit 2015, nga bashkëshorti i subjektit, në llogarinë e tij personale është vetëm 42.500 euro, duke iu referuar të ardhurave vjetore nga ky burim (qiradhënia, *de qua*), realisht rezulton se në vitin 2015, janë përfituar edhe 8.500 euro më shumë, të cilat në fund të vitit 2015 gjendeshin ende në llogarinë dyemërore, dhe që nuk janë përlllogaritur në analizën financiare që i është përcjellë subjektit pas mbylljes së rezultateve të hetimit, siç nuk ishte përfshirë edhe pjesa takuese e bashkëshortit e gjendjes së mbetur në llogarinë dyemërore, në po të njëjtën vlerë, me burim nga këto të ardhura⁵².

⁵² Referuar lëvizjeve bankare ka rezultuar se në llogarinë dyemërore në “Tirana Bank” janë transferuar në total 6 muaj x 8.500 euro = 51.000 euro nga shoqëria qiramarrëse, nga të cilat 25.500 euro janë transferuar në llogari të z. Sh. S. dhe 25.493 euro në llogari të z. K. S.. Më pas, janë transferuar 2 muaj x 8.500 euro = 17.000 euro nga qiramarrësi në llogari të z. Sh. S., nga të cilat 8.500 euro janë transferuar në llogari të bashkëpronarit K. S.. Ndërsa, në llogarinë dyemërore në “OTP Bank” janë transferuar 4 muaj x 8.500 euro nga qiramarrësi = 34.000 euro. Nga kjo shumë, 8.500 euro janë transferuar në llogari të z. Sh. S. dhe 4.250 euro në llogari të z. K. S. dhe ka mbetur një gjendje në llogarinë dyemërore e pashpërndarë mes bashkëpronarëve prej 21.250 euro, të cilat në bazë të raportit të bashkëpronësisë dhe ndarjes deri në atë moment, pjesa takuese e mbetur e z. Shkëlzen Selimi ishte 8.500 euro dhe e z. K. S. ishte 12.750 euro. Në përfundim, nga të dy bashkëpronarët është përfituar shuma totale prej 102.000 euro, nga të cilat z. Sh. S. ka marrë në total 42.500 euro, z. K. S. 38.250 euro dhe kanë mbetur pashpërndarë 21.250 euro.

96. Rrjedhimisht, duke e marrë në konsideratë edhe vlerën prej 8.500 euro, si të ardhur të përfituar në vitin 2015, automatikisht e njëjta shumë duhet të përfshihet në analizë edhe në zërin e gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare të ndryshme të familjes së subjektit. Ky veprim i dyfishtë nuk do ta ndryshonte rezultatin final të vitit 2015, pasi do të gjendeshim përballë të njëjtës balancë negative prej 208.382 lekësh – për shak se këto dy veprime do të neutralizonin njëra-tjetrën.
97. Për më shumë qartësi, në tabelën që vijon, janë paraqitur të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e kryera nga familja e subjektit në vitin 2015, si në variantin e nisur me rezultatet e hetimit, edhe në variantin e dytë, sipas pretendimeve të subjektit, duke konsideruar të ardhurat nga qiraja e pikës së tregimit me pakicë të karburantit në vlerën 51.000 euro dhe duke shtuar, gjithashtu, gjendjen e likuiditeteve në bankë me 8.500 euro (të pa konsideruar më herët për shkaqet e sipërcituara), nga ku rezulton i njëjti bilanc vjetor.

Tabela nr. 6: analiza financiare e vitit 2015

Përshkrimi (viti 2015)	Duke përfshire shumën 8,500 euro si të ardhur dhe gjendje në llogari	Pa përfshire shumën 8,500 euro
Te ardhura nga pagat	2 795 180	2 795 180
Te ardhura nga qiraja e karburantit	7 020 150	5 850 125
Dhurate nga N*. B*.	99 659	99 659
Shpenzime të vitit 2015	- 2 284 283	- 2 284 283
Likuiditetet në banke në fillim të vitit 2015	1 371 433	1 371 433
Likuiditetet në banke në fund të vitit 2015	- 9 210 521	- 8 040 496
Rezultati	- 208 382	- 208 382

98. Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, që ka përpunuar dhe përllogaritur të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm dhe përfundimtar ka rezultuar një bilanc negative në vlerën – 505.705 lekë, si rrjedhojë e një pamjaftueshmërie financiare e shpërndarë, ndër vite, (2011, 2013 dhe 2015). Vërehet se, ndonëse kjo pamjaftueshmëri nuk ka mbetur me burim financiar të panjohur, përkundrazi, ka rezultuar si pasojë; (i) e mosmarrjes në konsideratë, në analizën financiare të Komisionit, të gjithë shumën e dokumentuar prej 5.000 euro, si të përfituar nga shitja e automjetit tip “Fiat”, në vitin 2011; dhe (ii) e mosmarrjes në konsideratë të të ardhurave në shumën 2.200 euro, të përfituara në vitin 2013 nga qiradhënia e një pasurie dhe të deklaruar rregullisht si të ardhur nga ky burim, po në vitin 2013. Moskualifikimi i këtyre shumave si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka ardhur për shkak se tatimi mbi fitimin në fjalë, nuk është paguar në rastin e parë dhe është paguar pas paraqitjes së deklaratës *Vetting*, pra, përgjatë procesit të rivlerësimit, në rastin e dytë – ndonëse këtë detyrim e kishte marrë përsipër dhe konkretisht e ka shlyer qiramarrësi dhe jo subjekti i rivlerësimit. Nëse vetëm këto dy pretendime të subjektit do të merreshin në konsideratë, bilanci negativ i konstatuar në vitet respektive nga Komisioni do të zerohej, dhe subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mjaftueshmëri financiare. Nisur nga masa dhe dinamika e pamjaftueshmërisë financiare të lartpërmendur, trupi gjykues vlerëson se duke pasur në vëmendje parimin e proporcionalitetit, nuk mund të penalizohet subjekti për sa më lart.

99. Vijon tabela e përgjithshme e analizës financiare për periudhën 2003 – 2016.

VITI	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	250,000	700,000	671,647	4,280,146	773,304	-385,504	57,395	-116,915	1,139,431	1,839,300	18,923,051	1,267,503	7,839,088	7,547,664
Automjet Fiat Brava ***	250,000													
Apartament me sip. 57.1 m ² në Krujë në pjesë takuese BSH 25%														
Prenotim apartamenti				5,566,635										
Apartament banimi Sip. 98 m ² në Vlorë														
Garazh Sip. 32 m ² në Vlorë														
Automjet Mercedes Benz targa ***									900,000					
Automjet Citroen targa ***											420,000			
Pakë karburanti pasturia nr. ***, Vlorë											20,891,290			
Ndërysim likuiditeti	0	700,000	671,647	-1,286,489	773,304	-385,504	57,395	-116,915	239,431	1,839,300	-2,388,239	1,267,503	7,839,088	7,547,664
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	0	700,000	1,371,647	85,158	858,462	472,958	530,352	413,438	652,869	2,492,170	103,931	1,371,433	9,210,521	16,758,185
DETYRIME	0	0	0	3,566,635	-150,000	-1,054,840	-647,305	-494,164	-569,519	-604,988	5,627,036	-5,220,661	0	0
Detyrim shoqërisë *** shpk për prenotim apartamenti				3,566,635	-150,000	-3,190,468	-137,170							
Kredi 20.000 euro pranë NBG						2,135,627	-510,135	-494,164	-569,519	-604,988	-313,790			
Kredi 6.600.000 lekë Tirana Bank											5,940,826	-5,940,826		
Kthim detyrimi nga K.S. për pakën e karburantit												720,165		
Detyrim shoqërisë *** shpk për apartamentin														
PASURI NETO	250,000	700,000	671,647	713,511	923,304	669,336	704,700	377,249	1,708,951	2,444,288	13,296,015	6,488,163	7,839,088	7,547,664
Te ARDHURA dokumentuar	1,195,966	1,395,770	1,389,058	1,495,526	1,626,233	2,589,186	1,728,357	1,844,327	2,753,006	4,265,932	15,056,433	9,093,024	9,914,989	9,738,289
Te ardhura SR vertetuar	616,654	622,169	518,216	699,283	794,719	738,176	794,495	933,726	1,393,025	2,576,260	12,179,839	1,321,706	1,318,523	1,273,060
Te ardhura BSH vertetuar	579,312	773,601	870,842	796,243	831,514	1,851,010	933,862	910,601	1,359,981	1,689,672	2,876,594	7,771,318	8,596,466	8,465,229
SHPENZIME	187,728	281,592	558,317	462,350	532,254	1,669,076	796,540	848,006	1,162,053	1,511,143	1,939,743	2,411,421	2,284,283	2,049,585
Shpenzime jetese	187,728	281,592	438,228	438,228	492,354	546,480	683,100	683,100	683,100	705,120	705,120	1,099,990	1,121,380	1,175,460
Shpenzime interesa kredi 20.000 euro në NBG + sigurime						128,849	113,440	91,337	67,629	35,629	4,742			
Pagese tatimi mbi qirarë										98,475				
Shpenzime qiraje									96,000	288,000	288,000	288,000	288,000	288,000
Shpenzime arredimi sipas pyetësorit 2						800,000								
Pagese tatimi për shitjen e apt në Krujë						73,644								
Interesa dhe sigurime kredi 6.600.000 lekë Tirana bank											128,094	281,090		
Pagese për Unionin e Gjiqarëve										11,000	8,000	2,000		
Rivlerësim pasurie										43,600				
Shpenzime udhëtimi (TIMS)			120,089	24,122	39,900	120,103	0	73,569	315,324	329,320	805,787	740,341	874,903	586,125
Analiza dokumentuar	758,238	414,178	159,094	319,665	170,675	250,774	227,118	619,072	-117,998	310,500	-179,325	193,439	-208,382	141,040
CASH në lekë														
DIFERENCA E PAMBULUAR		-505,705												

13. Lidhur me apartamentin e blerë në vitin 2017, si dhe deklarimin e këtij viti

100. Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se nga përmbajtja e DIPP-së të vitit 2017, evidentohet fakti se subjekti i rivlerësimit, në dhjetor të vitit 2017 kishte porositur⁵³ blerjen e një apartamenti me sip. 155 m², kundrejt çmimit prej 85.000 euro, pagesat për të cilin ishin bërë me transfera nga llogaria bankare. Konkretisht, në datën 12.12.2017 nga llogaria bankare e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ishte transferuar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., shuma prej 40.000 euro, e cila ishte akumuluar në llogarinë, *de qua*, nga të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pikës së shitjes së karburantit me pakicë, si dhe ishte deklaruar, gjithashtu, detyrimi financiar i mbartur ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., në masën prej 45.000 euro.

101. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 5, datë 3.2.2020, ka bërë me dije, gjithashtu, se në datën 12.10.2018, në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., ishte likuiduar edhe kësti i dytë në shumën prej 30.000 euro me burim nga të ardhurat e dhënies me qira, ndër vite, të pasurisë (nr. 1) në bashkëpronësi. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se me të njëjtin burim financiar kanë përbulluar edhe kryerjen e punimeve shtesë në këtë apartament – sipas aktmarrëveshjes me shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k., në vlerën 1.720.000 lekë.

102. Ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2019, ka kryer shpenzime për arredimin, ndriçimin dhe orenditë shtëpiake, lidhur me këtë pasuri, në vlerën prej 24.511 euro dhe 200.000 lekë, me të njëjtin burim të ardhurash financiare si më lart.

⁵³ Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2017, për prenotimin e apartamentit në fjalë, sipas të cilës është paguar kësti i parë i apartamentit në momentin e lidhjes së kontratës në vlerën prej 40.000 euro dhe diferenca do të paguhet sipas kushteve të kontratës. Vlera totale e apartamentit është parashikuar në 85.000 euro.

103. Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi administrativ të thelluar dhe gjithëpërfshirës, iu drejtua subjektit me anë të pyetësorit nr. 7, për të sqaruar lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se apartamenti ndodhet në z. k. ***, ***, Njësia Administrative Farkë dhe referuar Udhëzimit nr. 3, dnatë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016”, siç konfirmon edhe ASHK-ja⁵⁴, vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë, për zonën në fjalë për vitin 2016 është në vlerën 66.500 lekë/m², e cila përputhet edhe me çmimin e blerjes së apartamentit në fjalë, të pasqyruar në kontratën e porosisë.
104. Lidhur me çmimin e tregut të lirë për lekë/m² ndërtim, në zonën e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision, shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2020, të ASHK-së Tiranë, nëpërmjet të cilës konfirmohet se çmimi i referencës në zonën Farkë – ku përfshihet ndërtesa në fjalë – është në vlerën 66.500 lekë/m². Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të sipërcituar, ndër të tjera, ka paraqitur gjithsej 7 kontrata sipërmarrje/shitblerje të po aq apartamenteve me vendndodhje në të njëjtën zonë, disa prej të cilave ishin ndërtuar dhe shitur nga po e njëjta shoqëri ndërtuese, nga ku ka rezultuar se edhe në këto raste çmimet për lekë/m² kanë qenë në të njëjtat nivele me apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, përpos luhatjeve të mundëshme të dinamikës së tregut të lirë nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ – pasi janë përdorur të gjitha mjetet e mundshme hetimore të aplikuara edhe në shumë raste të tjera të ngjashme, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit mbi këtë temë – nuk janë gjetur elemente apo rrethana faktiko-ligjore që mund të çonin në hipotetizimin e ndonjë trajtimi preferencial apo çmimi fiktiv, të aplikuar në favor të subjektit të rivlerësimit.
105. Gjithashtu, lidhur me ekzistencën e mundëshme të ndonjë konflikti interesash me palën shitëse, nuk kanë rezultuar shqyrtime dhe/ose vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit, lidhur me çështje ku palë mund të kishte qenë shoqëria shitëse apo ortakët/administratorët e saj. Kjo temë do të trajtohet në mënyrë më të zgjeruar, në lidhje me të gjitha hetimet e kryera mbi ndonjë konflikt interesash të mundshëm, me individët apo personat juridikë ose fizikë me të cilët subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie kontraktore, juridiko-civile apo familjare/të posaçme.
106. Po ashtu, në deklarin e pasurisë për vitin 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe një kontratë huaje në shumën prej 42.500 euro, të dhënë në favor të z. K. S.⁵⁵. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 3.2.2020, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion kontratën e huas⁵⁶ në fjalë, si dhe lëvizjet bankare të cilat konfirmojnë dhënien dhe kthimin⁵⁷ e kësaj huaje, nga dhe nëpërmjet burimeve të ligjshme financiare.
107. Nga shqyrtimi i të dhënave bankare është konstatuar se nga llogaria e përbashkët, pra, dyemërore Sh. dhe K. S. (në cilësinë e bashkëpronarëve të pikës së shitjes së karburantit me pakicë⁵⁸), është transferuar në favor të z. K. S. me përshkrimin “huadhënie nga ortakut” gjithsej shuma prej 42.550⁵⁹ euro. Gjithashtu, nga vlerësimi i aktivitetit të

⁵⁴ Po ashtu, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ASHK-ja Tirana Rurale 1 ka informuar se në emër të shoqërisë “*****” sh.p.k, nuk figuron pasuri dhe, rrjedhimisht, nuk mund të japë informacion lidhur me transaksione të shitjeve nga kjo shoqëri.

⁵⁵ Në datën 26.12.2018 rezulton të jetë nënshkruar kontrata e shitblerjes me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., në të cilën rezulton se z. K. S. ka shitur pjesën takuese prej ½ të pasurisë “pikë karburanti” shoqërisë tregtare “*****” sh.a. Për vitin 2018, z. K. S. në plotësim të DIVA-s së tij, ka deklaruar të ardhurat nga shitja e pasurive në masën 25.332.747 lekë dhe nga qiraja në masën 12.404.872 lekë, të cilat përputhen me të ardhurat e rezultuara nga të dy burimet.

⁵⁶ Kontrata e huas nr. *** rep., nr. ***kol., datë 27.12.2017.

⁵⁷ Huaja është kthyer në datën 17.12.2018 në llogarinë e z. Sh. S. në “OTP Bank”.

⁵⁸ Të cilën më pas z. K. S., pjesën takuese prej 50%, ia ka shitur shoqërisë “*****” sh.a.

⁵⁹ Këto kalime janë kryer: 26.400 euro më 10.11.2017; 11.800 euro më 12.12.2017; 100 euro më 10.11.2017; 4.250 euro më 26.12.2017.

llogarisë së mësipërme evidentohet që shumat e kredituara në këtë llogari bankare rrjedhin vetëm nga të ardhurat e përfituara sipas kontratave të qirasë së pasurisë nr. 1.

108. Në tabelën që vijon është paraqitur në mënyrë të përmbledhur analiza e investimeve, shpenzimeve të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit, si dhe e të ardhurave të realizuara përgjatë vitit 2017⁶⁰.

Tabela nr. 7: analiza financiare e vitit 2017

Përshkrimi (viti 2017)	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Pagese pjesore prej 40,000 Euro per porositjen e apartamentit ne Tirane me cmim total 85,000 Euro	- 5,318,000
Likuiditete te vitit 2017	5,027,698
Shpenzime gjate vitit	- 2,786,047
Të ardhura nga punësimi te subjektit dhe b/shortit dhe qiraja e pikes se karburantit (te dokumentuara)	9,626,127
Dhene hua Z. K. S.	- 5,650,375
Rezultati	899,403

109. Nisur nga sa më sipër, sipas rezultateve të analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme, përgjatë vitit 2017: (i) për blerjen e pasurisë së analizuar; (ii) për huadhënien; (iii) për përballimin e shpenzimeve. Gjithashtu ka rezultuar se janë deklaruar saktë të gjitha veprimet financiare të kryera në këtë vit dhe burimet financiare përkatëse.

14. Lidhur me të ardhurat e z. K. S. në periudhën prill 2006 – prill 2013⁶¹

110. Ndonëse nuk ka rezultuar përgjatë hetimit administrativ që z. K. S. të ketë dhënë hua apo të ketë dhuruar pasuri apo shuma në favor të familjes së subjektit të rivlerësimit, për të cilat duhej të vlerësohej mundësia e tij financiare për krijimin e tyre – me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme që kanë gjeneruar (pasurinë apo të hollat), që mund të ishin përfutur nga subjekti i rivlerësimit dhe nga familja e saj, Komisioni, për të shuar çdo dyshim të mundshëm mbi burimet e përdorura – duke u nisur nga marrëdhënia e ngushtë familjare, edhe mbi pasuri të mundshme të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo të personit të lidhur me të, në emër të personit tjetër të lidhur por edhe nga fakti se bashkëshorti i subjektit ka qenë në bashkëpronësi për disa vite me babanë e tij, të pasurisë nr. 1, të sipërtrajtuar, ku kishin investuar së bashku në vitin 2013 – e ka konsideruar z. K. S. si person tjetër të lidhur dhe ka kryer hetime të thella dhe gjithëpërfshirëse për të verifikuar dhe qartësuar dinamikën faktike dhe panoramën e plotë në lidhje me burimet financiare të tij, për sa i përket pagesës së shumës prej 101.000 euro, të kryer në vitin 2013 – si pjesë e investimit të përbashkët me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.
111. Në funksion të sa më sipër, fillimisht janë përlllogaritur të ardhurat e z. K. S., të përfituara nga dhënia me qira e një pike të shitjes me pakicë të karburantit me vendndodhje në

⁶⁰ Gjatë vitit 2018, subjekti dhe bashkëshorti kanë likuiduar kështu e dytë të blerjes së apartamentit në shumën prej 30,000 euro, si dhe kanë arkëtuar shumën prej 42,500 euro të kthyer nga z. K.. Gjithashtu, subjekti dhe bashkëshorti gjatë vitit 2018 kanë realizuar të ardhura në të njëjtat nivele me vitin 2017. Në këto kushte, duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e investimeve të vitit 2018 dhe analiza e detajuar nuk konsiderohet e nevojshme.

⁶¹ Në datën 10.5.2013 z. K. S. ka paguar shumën prej 101.000 euro për blerjen e 50 % të pikës së karburantit nga pala shitëse "Tirana Bank" dhe diferencën e pjesës takuese ai e ka paguar nëpërmjet kredisë bankare.

Krujë, të blerë prej tij në vitin 1997 – përpara se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj të emëroheshin në detyrë (respektivisht në vitet 2000 dhe 1999) dhe përpara martesës së tyre (shtator 2003), si dhe të burimeve të tjera financiare të dokumentuara sipas materialit të administruar, si vijon:

- i. Kontratë qiraje, datë 1.8.2000, me afat 2-vjeçar, me qiramarrës shoqërinë “***” sh.p.k., me qira mujore 130.000 lekë/muaj. Të ardhura *bruto* (130.000 x 24 muaj = 3.120.000 lekë). Të ardhura, *neto*, në shumën 2.808.000 lekë⁶².
- ii. Kontratë qiraje, datës 26.4.2006, deri më 1.5.2011, me shoqërinë “***” sh.p.k., me çmim 180.000 lekë/muaj. Të ardhura *bruto* (150.000 lekë x 8 muaj⁶³) + (180.000 lekë x 52 muaj) = 10.560.000 lekë. Të ardhura, *neto*, në shumën 9.504.000 lekë⁶⁴.
- iii. Kontratë qiraje 5-vjeçare, datës 29.4.2011, me shoqërinë “***” sh.p.k., me çmim 180.000 lekë/muaj. Të ardhura *bruto* të përlllogaritura deri në maj të vitit 2013 (momenti kur z. K. S. ka kryer pagesën) 180.000 lekë x 24 muaj = 4.320.000 lekë. Të ardhura, *neto*, në shumën 3.888.000 lekë.
- iv. Kontratë qiraje 5-vjeçare, datë 10.9.2012, me qiramarrës S. B., për dhënien e katit përdhes të ndërtesës trikatëshe me sip. 187.81 m², me çmim 80.000 lekë/muaj, shumë e cila do të paguhet paradhënie për çdo vit. Të ardhura, *bruto*, të përlllogaritura deri në maj të vitit 2013: 80.000 lekë x 12 muaj = 960.000 lekë. Të ardhura, *neto*, në shumën 864.000 lekë⁶⁵.
- v. Të ardhura nga shitja e apartamentit me vendndodhje në Krujë, me kontratën e datës 20.5.2008 me çmim 3.100.000 lekë⁶⁶.
- vi. Të ardhura nga aktiviteti si Person Fizik i të birit të z. K. S., shtetasi R. S. (NIPT ***), të deklaruar për periudhën tatimore 2013, shuma prej 1.800.000 lekësh⁶⁷.
- vii. Të ardhura nga pensioni i znj. Xh. S. duke filluar nga shkurti i vitit 2007 në masën 11.034 lekë/muaj.
- viii. Të ardhura nga aktiviteti shoqërisë “***” sh.p.k. (NIPT ***), për periudhën 2003 – 2006, në shumën totale prej 900.618 lekësh⁶⁸.

112. Lidhur me kërkesën e Komisionit për të vendosur në dispozicion dokumentacionin që të provojë pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga vjehri i subjektit nga qiradhënia, nëpërmjet kontratave të sipërcituara, në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti sqaroi se në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim, nuk ka qenë detyrim i z. K. S. pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura, për sa kohë ka qenë në marrëdhënie

⁶² Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka sqaruar se të ardhurat nga qiraja me shoqërinë “***” sh.p.k. për periudhën 2000 -2002 janë paguar *cash*. Subjekti ka bashkëngjitur një shkresë nr. *** prot., datë 14.3.2001, nga drejtoria e tatim-taksave për miratimin e hapjes së pikës “***”, për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së qirasë dhe regjistrimin e kontratës në organin tatimor. Lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore nga kjo shoqëri në burim, subjekti i është drejtuar DRT-së Tiranë me shkresën datë 4.8.2020, për të cilën nuk ka bashkëngjitur përgjigje.

⁶³ Sipas kontratës së qirasë, shuma e qirasë mujore gjatë vitit të parë do të ishte 150.000 lekë dhe në vazhdimësi, do të ishte 180.000 lekë.

⁶⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka sqaruar se të ardhurat nga qiraja me shoqërinë “***” sh.p.k. për periudhën maj 2006 - gusht 2007 janë paguar *cash* dhe vjehri i saj nuk ka ruajtur dokumentacion për marrjen, pasi për të nuk kanë pasur vlerë ligjore. Më pas, për periudhën shtator 2007 – 2013, detyrimet e qirasë janë likuiduar në llogari të djalit të z. K., z. R. S., duke vënë në dispozicion lëvizjet bankare të këtij të fundit, në të cilën rezultojnë pagesat në fjalë. Lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore nga kjo shoqëri në burim, subjekti i është drejtuar DRT-së Durrës dhe DRTM-së me shkresën datë 4.8.2020.

⁶⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka sqaruar se të ardhurat nga qiraja me shoqërinë “S. B.” Person Fizik janë paguar *cash* dhe vjehri i saj nuk ka ruajtur dokumentacion për marrjen, pasi për të nuk kanë pasur vlerë ligjore.

⁶⁶ Duke qenë se kjo pasuri ka qenë në bashkëpronësi të shtetasve K., Xh. dhe Sh. S. (nga 1/3 pjesë secili), në analizë janë konsideruar vetëm të ardhurat e shtetasve K. dhe Xh. S. të përfituara nga kjo shitje, pra 2/3 e shumës 3.100.000 lekë, pra 2.066.666 lekë.

⁶⁷ Në formularin e deklarimit dhe pagesës për tatim-fitimin e thjeshtuar të aktivitetit R. S. PF, rezultoi se për vitin 2013 ka deklaruar të ardhura prej 1.800.000 lekësh dhe shpenzime 0 lekë.

⁶⁸ Informacion i ardhur nga DRT-ja Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2020. Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka sqaruar se nga informacionet e dhëna nga kunati i saj, z.R. S., kjo shoqëri, pavarësisht deklarimeve në organet tatimore, ka realizuar përgjatë periudhës 2002 – 2006, të ardhura në masën rreth 6.000.000 lekë.

qiraje me persona tregtarë që ishin tatimpagues, këta të fundit e kanë pasur detyrimin e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja.

113. Nga sa më lart, duke mos qenë në kushtet e kryerjes së një analize financiare të mirëfilltë – nisur nga dispozitat kushtetuese e ligjore, si dhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbi kufizimet e kompetencave të Komisionit, lidhur me persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ky i fundit dhe familja e tij nuk kanë pasur ndonjë përfitim nga të ardhurat e z. K. S. – Komisioni ka kryer përlllogaritjen e burimeve financiare të realizuara nga familja e personit tjetër të lidhur (*ex nunc*) me pikënisje vetëm nga prilli i vitit 2006 (pasi asokohe kishte përfunduar rindërtimi i godinës në ***, Fushë- Krujë, dhe duke evituar kështoj dyshimet mbi përdorimin e mundshëm të këtyre të ardhurave me destinacion punimet e rikonstruksionit në fjalë). Nga kjo përlllogaritje – detajet e zërave përkatës janë pasqyruar në tabelën vijuese (pa marrë në konsideratë edhe burimet e tjera të paraqitura, si p.sh. të ardhurat nga sipërfaqja e konsiderueshme e tokës bujqësore në pronësi dhe posedim të tij), ka rezultuar një mjaftueshmëri financiare me burime të ligjshme për të justifikuar shumën e investuar nga z. K. S. në vitin 2013 (për blerjen e pjesës takuese 50 % të pikës së shitjes së karburantit me pakicë, të cilën ai më tej e ka shitur në favor të shoqërisë së hidrokarbureve “Kastrati” sh.p.k.).

Tabela nr. 8: të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së z. K. S. përgjatë periudhës prill 2006 – prill 2013

Burimi i te ardhurave	Shuma
Te ardhura nga qiraja	14,256,000
Te ardhura nga R. S. PF	600,000
Te ardhura nga *** Shpk	114,878
Te ardhura nga shitja e pasurise ne Kruje	2,066,667
Te ardhura nga pensioni	816,516
Totali i te ardhurave	17,854,061
Investimi ne vitin 2013 ne Vlore	- 14,161,210
Shpenzime jetese	- 2,942,067
Rezultati	750,784

114. Nisur nga sa më lart, në përfundim të hetimit administrativ, *de quo*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar se burimet financiare të dokumentuara që z. K. S. (së bashku me të ardhurat e familjes së tij) ka përfituar vetëm në periudhën prill 2006 – prill 2013, arrijnë në vlerën *neto* 17.854.061 lekë. Nga këto përlllogaritje financiare, pasi janë zbritur edhe shpenzimet jetike për të gjithë familjen, ka rezultuar se të ardhurat që mund të kurseheshin nga kjo familje arrijnë të justifikojnë burimin e ligjshëm për investimin e kryer në shumën prej 101.000 euro, në vitin 2013.
115. Gjithashtu, subjekti është pyetur mbi mënyrën e ruajtjes së shumave monetare të përdorura për pagesën me likuiditet në fjalë. Shpjegimet lidheshin me kulturën/zakonin e përgjithshëm/e që kishin në ato vite shqiptarët për të mbajtur kursimet e tyre *cash* në banesë, për më tepër pas mungesës së besimit tek institucionet bankare, pas fenomenit të humbjeve masive të kursimeve në vitin 1997, nga të ashtuquajturat “firma piramidale”. Për rrjedhojë, shumat e tërhequara nga llogaritë bankare (të konfirmuara nga lëvizjet përkatëse), vit pas viti, deri në momentin e kryerjes së pagesës në fjalë, ishin ruajtur në vijimësi pranë banesës familjare të z. K. S..

116. Po ashtu, e pyetur përgjatë seancës dëgjimore, subjekti është shprehur se shkak i bashkëinvestimit të bashkëshortit me babanë e tij kishte të bënte me faktin se ky i fundit kishte një eksperiencë shumëvjeçare në tregtimin me pakicë të karburanteve. Duke mos e kryer dot vetëm këtë investim, pasi kanë shitur edhe apartamentin dhe garazhin, të dy bashkëinvestitorët ndoqën procedurat e rregullta ligjore të parashikuara nga banka, për blerjen e pasurisë në fjalë, fillimisht me rezervë dhe më pas për likuidimin e plotë është marrë një kredi bankare, nga subjekti dhe bashkëshorti, e cila më pas është likuiduar me të ardhurat e përbashkëta, duke riekulibruar në këtë mënyrë atë disbalancë financiare që ishte krijuar midis dy investitorëve në momentin e investimit.

15. Lidhur me ndërtesën e ndodhur në *, Fushë-Krujë**

117. Nga dokumentacioni i administruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës⁶⁹ ka rezultuar se z. K. S. ka qenë aplikues në një proces legalizimi për shtesën e ndërtesës trikatëshe me sip. 624 m² të ndodhur në ***, Fushë - Krujë⁷⁰.

118. Ndërtimi në fjalë deklarohet të ketë filluar në vitin 2005 dhe të ketë përfunduar në fillim të vitit 2006. Për ndërtimin e këtij objekti është deklaruar se vlera e shpenzuar ka qenë rreth 14.000.000 lekë⁷¹ dhe punimet janë realizuar me angazhim personal të vjehrrit dhe kunatit.

119. Procedurat e legalizimit të objektit kanë filluar në bazë të vetëdeklarimit të z. K. S., dorëzuar më 8.11.2006 në strukturat e njësisë vendore. Lidhur me destinacionin e këtij ndërtimi, subjekti ka sqaruar se në lejen e legalizimit nr. ***, datë 17.9.2009, objekti i legalizuar në emër të z. K. S. është cilësuar gabim si godinë shërbimesh trikatëshe, me sip. 624 m², pasi ndërtesa, ashtu siç pasqyrohet edhe në certifikatën e pronësisë, ka një sipërfaqe gjithsej prej 624 m². Por ndërtesa nuk është godinë shërbimesh tre kate, pasi objekti që në fillim është projektuar dhe ndërtuar me funksion të përzier shërbimi dhe banimi.

120. Subjekti ka shpjeguar, gjithashtu, se në datën 29.7.2009, z. K. S. ka paguar në rrugë bankare për llogari të ALUIZNI-t Durrës, taksën e ndikimit në infrastrukturë. Ky detyrim ligjor përcaktohet se llogaritet në bazë të vlerës së investimit të objektit në proces legalizimi dhe që në rastin konkret është vlerësuar në shumën 27,490 lekë për metër katror. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se duke qenë se ndërtimi është realizuar përgjatë vitit 2005 deri në janar të vitit 2006, në referim të kostos së ndërtimit për metër katror të miratuar në vitin 2005 dhe 2006 nga EKB-ja⁷² për zonën në fjalë: Fushë- Krujë/Krujë, vlera e investimit të këtij ndërtimi është objektivisht në një masë më të ulët sesa vlera (624 m² x 27.400 lekë = 17.153.760 lekë) e llogaritur në vitin 2009 për qëllime të arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë të objektit të legalizuar.

121. Trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, duke pasur në vëmendje:

- i. sa më sipër është shprehur, për sa i takon cilësimit juridik të z. K. S., në kuadrin e këtij procesi rivlerësimi dhe në raport me subjektin;
- ii. pasuria në fjalë ekziston prej shumë më herët se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrë, ndonëse është rikonstruktuar në vitin 2005 – fillim 2006, me kursime të

⁶⁹ Z. K. S. rezulton të ketë blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.11.2001, apartamentin me nr. pasurie ***, kundrejt çmimit 1.600.000 lekë, në Krujë.

⁷⁰ Ky ndërtim rezulton të jetë në të njëjtën vendndodhje me pikën e tregimit të karburantit të blerë nga z. K. S. në vitin 1997.

⁷¹ Për ndërtimin e këtij objekti janë deklaruar si burim: të ardhurat nga pika e karburantit nga dhënia me qira ose përdorimi nga vetë pronari, të ardhurat nga emigracioni të z. R. S. (periudha 1994 – 2002), të ardhura nga punësimi i shtetasve Xh. dhe K. S., si dhe të ardhura nga shfrytëzimi i tokës në pronësi.

⁷² Referuar udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, kostoja mesatare e ndërtimit në vitin 2005 në Krujë ka qenë 24.768 lekë/m², çka do të rezultonte në një kosto totale (624 x 24.768) = 15.455.232 lekë.

- realizuar nga vjehri, përgjatë shumë vitesh më herët se subjekti i rivlerësimit të martohet, në shtator të vitit 2003;
- iii. nuk rezulton që pasuria në fjalë të ketë ndonjë lidhje përfitimi, përdorimi apo bashkëinvestimi nga subjekti i rivlerësimit apo nga familja e saj;
 - iv. dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe jurisprudencën e konsoliduar interpretuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me kufizimin e shtrirjes së hetimit administrativ mbi pasuritë e personave të tjerë të lidhur⁷³;
 - v. qëndrimet orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të konfirmuara edhe në disa nga vendimmarrjet e tij më të fundit dhe, konkretisht, në vendimin nr. 4/2020 (JR), ku shprehet se: “[...] Pra, në këndvështrim të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave. [...]”, si dhe në vendimin nr. 7/2020 (JR), ku argumentohet se: “[...] Në analizë të fakteve dhe rrethanave lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të të apartamentit të babait të tij, z. M. K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M. K., si më sipër, mund të trajtohet teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 135 m² dhe dy garazhe me sip. 18 m², subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalojë objektin e procesit të rivlerësimit. [...]”;
 - vi. mospërfshirjen e z. K. S. në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në cilësinë e dhuruesit apo huadhënësit, të parashikuar nga pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, apo si person i lidhur për sa kohë nuk ka jetuar dhe nuk ka qenë ndonjëherë anëtar i familjes së subjektit të rivlerësimit dhe as ka qenë/është i përfshirë në të njëjtën certifikatë familjare me të, vlerëson se në këto kushte kryerja e një analize financiare të mirëfilltë, *ex tunc*, pa kufizim kohor dhe mbi të gjitha pasuritë e familjes së z. K. S., në funksion të këtij procesi rivlerësimi, do të ishte e padobishme në kuptimin substancial, pasi do të shkonte përtej kompetencave kushtetuese e ligjore të Komisionit, duke tejkaluar objektin e procesit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, edhe në këndvështrimin procedural, rezultati i arritur nga analiza financiare hipotetike, në çdo rast, nuk do të ishte i përdorshëm me efikasitet dhe në mënyrë legjitime për të ngarkuar me barrë prove apo, për më tepër, me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit edhe nëse do të konstatoheshin problematika apo mangësi lidhur me krijimin, shtesën apo rikonstruktimin e kësaj pasurie. Në të kundërt do të gjendeshim përballë një sforcimi apo interpretimi deformues të frymës së ligjit në raport me rrethanat faktiko-ligjore, çka do të mund të tingëllonte si një, *fumus persecutionis*.

122. Në përfundim, duke e vlerësuar kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi, në tërësinë e tij dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, trupi gjykues çmon

⁷³ Shihni vendimet nr. 4/2020 (f. 39-40) dhe nr. 7/2020 (f. 29-30), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale -505.705 lekë (duke mbajtur në vëmendje edhe rrethanat specifike të përshkruara në paragrafin pararendës nr. 98, si dhe faktin që është e shpërndarë në vite), sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet⁷⁴ e subjektit nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Rilinda Selimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. Rilinda Selimi ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuara.

B. KONTROLLI I FIGURËS

123. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 në Komision është përcjellë raporti me nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi. Me shkresën e datës 8.10.2019, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht, me vendimin nr. ***, datë 4.10.2019, të KDZh-së.
124. Në vijim, Komisioni, me shkresat e datave 27.2.2020 dhe 23.4.2020, u ka rikërkuar organeve ligjzbatuese riverifikimin dhe përditësimin e të dhënave lidhur me këtë subjekt rivlerësimi. Me shkresën e datës 14.5.2020, DSIK-ja i bën me dije Komisionit se në bazë të komunikimeve të organeve ndihmëse (komunikimi i fundit daton më 8.5.2020) ka rezultuar se: “[...] për subjektin e rivlerësimit Rilinda Q. Selimi, prej datës 2.11.2017⁷⁵ deri më sot, nuk disponon të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme [...]”.
125. Gjithashtu, Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të thellë dhe gjithëpërfshirës, nisur nga disa të dhëna publike, ka ndërmarrë disa hapa të mëtejshëm hetimorë në mënyrë të pavarur, duke kryer konkretisht verifikime dhe kërkuar shpjegime lidhur me disa persona, me të cilët edhe subjekti i rivlerësimit mund të kishte pasur kontakte apo marrëdhënie shoqërore dhe/ose profesionale.
126. Nga verifikimet e kryera, lidhur me një sërë personash⁷⁶ për të cilët nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni apo nga deklaratimet e subjektit ishte konstatuar se kishin pasur marrëdhënie tregtare/interesi dhe mund të kishin pasur edhe marrëdhënie shoqërore apo kontakte të mëtejshme me subjektin e rivlerësimit, rezultoi se asnjëri prej tyre nuk kishte shkaqe për t’u dyshuar apo konsideruar si një kontakt potencial i papërshtatshëm, për sa kohë nuk kanë rezultuar dënime apo procedime në emër të tyre për ndonjë nga veprat penale të përfshira në grupimin e atyre të cilësuar në gamën e krimit të organizuar, sipas pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10191, datë 3.12.2009. Gjithashtu, është verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit mund të kishte shqyrtuar ndonjë çështje ku ndonjëri nga shtetasit në fjalë mund të kishte qenë si palë ndërgjyqëse dhe nuk ka rezultuar një gjë e tillë.
127. Nisur nga disa rrethana publike, që mund të hidhnin hije dyshimi mbi kontakte të mundshme të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, të shkaktuara apo diktuar nga ekzistenca e mundshme e marrëdhënieve familjare më të hershme, qoftë edhe në mënyrë sporadike apo rastësore, përfshirë këtu edhe të dhënat e konstatuara në disa elementë të

⁷⁴ Duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet jurisprudenciale në vendimet nr. 11 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 11; 13; 22 (JR), 2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁷⁵ Datë në të cilën është hartuar raporti i sipërpërmendur – që ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit në fjalë.

⁷⁶ Konkretisht shtetasit: A. D. (identifikuar si palë blerëse e automjetit tip “Benz 270CDI”); A. Sh. dhe I. Ç. (të identifikuar si pronarë të dy automjeteve për përdorimin e të cilëve, në periudha të caktuara, kishte të drejtë edhe subjekti i rivlerësimit); A. Gj.; D. M.; N. G.; T. L.; E. H.; E. M.; A. C.; N. L. (të identifikuar si persona me marrëdhënie tregtare: shitës ose blerës automjeteve, qiradhënës, huadhënës etj.), S. A. (i identifikuar si palë në shitblerjen e një pasurie të paluajtshme).

përmbajtjes së vendimit nr. 3/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që lidheshin me kontakte të papërshtatshme, njohje apo marrëdhënie familjare të bashkëshortit të subjektit apo nga rrethana konkrete, siç ishte gjetja e emrit të subjektit si një përdoruese e mundshme, në policën e sigurimit (TPL) të një automjeti tip “BMW” modeli 353D – Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 6, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të jepte shpjegime lidhur me përdorimin e mundshëm të këtij automjeti, si dhe mbi ekzistencën e mundshme të ndonjë marrëdhënieje personale apo familjare, frekuentimi, kontaktimi me pronarin e automjetit *de quo* dhe/ose me shtetasin F. D., i cili rezultonte se ishte ndaluar në ngarje e sipër të këtij automjeti, më 27.11.2011 – për sa kohë rezultonte e provuar dhe e pranuar se shtetasi F. D., kishte pasur marrëdhënie të hershme dhe njohje prej shumë vitesh me bashkëshortin e subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

128. Në përgjigjet e përcjella në Komision në datën 11.6.2020, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, ka sqaruar se:

i. *“[...] Lidhur me faktin që citoni se: emri im figuron si përdorues në policën e sigurimit të këtij automjeti, të lëshuar në datën 27.6.2011 dhe me vlefshmëri njëvjeçare deri në datën 26.6.2012; unë nuk kam pasur dijeni. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, bashkëshorti im më ka sqaruar se sigurimin TPL e ka kryer shtetasi I.{..} Ç.{..} si pronari i automjetit, nga ku rezulton se ka vendosur dhe emrin tim si përdorues potencial.*

ii. *Deklaroj se unë nuk e kam përdorur këtë automjet as si drejtues dhe as si pasagjer. Ky automjet është përdorur nga bashkëshorti, gjithsej 2 javë, në rrethanat dhe për nevojat e sipërspjegjuara. Afati njëvjeçar i vlefshmërisë së policës së sigurimit TPL është i përcaktuar, sipas ligjit, nga rregullat e miratuara nga autoriteti përkatës (AMF), pavarësisht kohës së përdorimit të automjetit nga personi tjetër jo pronar. Ky afat nuk mund të njëjtësohet me kohën e përdorimit të automjetit të siguruar [...].*

iii. *[...] Unë nuk kam pasur marrëdhënie shoqërore me z. I.{..} Ç.{..}. Ky person ishte njohje personale dhe shoqërore e bashkëshortit [...]. Unë nuk kam pasur dijeni për personin/at pronarë të mëpasëm të automjetit deri në përfundimin e kohëzgjatjes së policës në fjalë [...] [...]. Para dhe pas transferimit me banim në qytetin e Tiranës unë personalisht nuk kam pasur raport shoqëror me shtetasin F{...} D{...}. Njohja ka qenë personale e bashkëshortit tim dhe e familjarëve të tij [...].”*

129. Në mbështetje dhe në plotësim të përgjigjeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto dokumente: (i) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.7.2011, e automjetit tip “Fiat”, me targa ***; (ii) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2011, e automjetit tip “Benz E 270”, me targa ***; (iii) vërtetim nr. *** prot., datë 19.11.2019, i Gjykatës së Lartë.

130. Gjithashtu, subjekti, në seancën dëgjimore të datës 10.12.2020, veç të tjerash, ka depozituar vendimin nr. ***, datë 17.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me palë ndërgjyqëse: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të dyshuar shtetasit: D. M., G. S., F. (E.) D. dhe Ç. B., të akuzuar për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotikëve”. Nga shqyrtimi i vendimit konstatohet se Prokuroria ka ndryshuar akuzën në ngarkim të shtetasit F. D., nga “trafikim të lëndëve narkotike” në “moskallëzim krimi” të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin e sipërcituar, ka vendosur denimin për trafikim të lëndëve narkotike për të pandehurit e tjerë dhe deklarin fajtor të të pandehurit F. D., vetëm për kryerjen e veprës

penale “moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit burgim dhe në aplikim të nenit 406, uljen e dënimit në 8 muaj burgim. Për rrjedhojë, rezultoi se shtetasi F. D. është shpallur i pafajshëm për veprën penale për të cilën kishte qenë i dyshuar/akuzuar dhe që përfshihej mes veprave të krimit të organizuar dhe që ishte bërë shkak për konsiderimin e tij si një kontakt potencial të papërshtatshëm.

Vlerësimi i trupit gjykues

131. Nga analizimi i dokumentacionit të sipërpërmendur rezultoi se shpjegimet e subjektit, në referencë të tyre, gjenden të bazuara, pasi nëpërmjet tyre provohet se kohëzgjatja e mungesës së një automjeti në pronësi të familjes së subjektit shtrihet në segmentin kohor 9.7.2011 – 26.7.2011, pra, nga shitja e automjetit tip “FIAT” deri në blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, ndonëse kjo provon zotërimin e një mjete para dhe pas këtyre datave, por nuk përjashton përdorimin e një tjetër mjete. Gjithashtu, konsiderohet bindës argumentimi se kohëzgjatja e një të drejte përdorimi mbi një send nuk mund të konsiderohet si ekuivalent i një përdorimi konkret dhe të vazhdueshëm, pasi jo detyrimisht një e drejtë në letër, *de jure*, mund të jetë përdorur/gëzuar praktikisht, *de facto*. Për më tepër që rrethanat e konstatuara e lidhin ngushtësisht vendosjen e emrit të subjektit në TPL me aplikimin e këtij opsioni sigurimi në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, nuk mund të përjashtohet mundësia që, pikërisht nisur nga njohja që pronari i automjetit kishte me bashkëshortin e subjektit dhe nevojës së këtij të fundit për përdorimin e një automjeti tjetër – për sa kohë do të privohej nga automjeti në pronësi e së paku deri në zëvendësimin e tij dhe duke konsideruar teorikisht mundësinë e ndonjë udhëtimit si çift ndërkohë, apo të nevojës së përdorimit të mundshëm edhe nga subjekti – të jetë vendosur edhe emri i subjektit, thjeshtë si një obsion hipotetik, nëse do ta diktonin rrethanat. Gjithsesi, në rrafshin provues të rastit konkret, për sa kohë mungon prova pozitive mbi përdorimin e këtij automjeti edhe nga znj. Rilinda Selimi dhe të njohjes apo ekzistencës së marrëdhënieve e kontakteve direkte midis kësaj të fundit dhe pronarëve të automjetit tip “BMW” modeli 353D, që rezultuan dy përgjatë afatit të vlefshmërisë së TPL-së, subjekti nuk mund të provonte të kundërtën.
132. Në çdo rast, lidhur me sa më lart, vërehet se edhe nëse do të ishte provuar apo pohuar/pranuar përdorimi i automjetit, *de quo*, nga subjekti i rivlerësimit, kjo rrethanë nuk do të cenonte gjithsesi aspektin e figurës së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë shtetasit R. H. dhe I. Ç. – respektivisht pronarë të automjetit tip “BMW” modeli 353D, në momentin e hartimit të kontratës së siguracionit dhe të TPL-së në fjalë (datë 27.6.2011) dhe në momentin e ndalimit të këtij automjeti më 27.11.2011 (pasi ky automjet ishte shitur ndërkohë, nga njëri te tjetri, më 1.8.2011), nuk kanë rezultuar që të mbartnin procedime apo dënime në ngarkim të tyre, të tillë për t’i kualifikuar ata potencialisht si kontakte të papërshtatshme, në kuptimin e pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Ky fakti i fundit, jo vetëm që rezultoi nga verifikimet e Komisionit dhe nga dokumentacioni përkatës, por është konstatuar katërcipërisht dhe shprehur qartësisht edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. 3 (JR), të datës 7.2.2019⁷⁷.
133. Në vijim të sa më sipër dhe duke mbajtur në vëmendje jo vetëm konstatimet dhe rezultancat e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për znj. Rilinda Selimi, por edhe faktet, rrethanat, arsyetimet dhe qëndrimet specifike që bëjnë pjesë në përmbajtjen e vendimit të sipërcituar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vlerësohet se përveç sa më lart, duhet analizuar dhe adresuar edhe një tjetër rrethanë, nga ku, në pamje të parë, mund të ngrihen hije dyshimi mbi një kontakt të papërshtatshëm që edhe subjekti i rivlerësimit, mund të kishte pasur dhe, konkretisht, me shtetasin F. D., për sa kohë ky i fundit kishte

⁷⁷ Vendimi nr. 3 (JR), datë 7.2.2019, paragrafët 66 dhe 67, f. 24.

qenë në marrëdhënie miqësore shumëvjeçare me bashkëshortin e subjektit, madje kjo njohje ishte cilësuar si e shëndetshme dhe familjare prej tij.

134. Lidhur me situatën konkrete të shtetasit F. D., por edhe mbi kriterin e figurës në tërësi, trupi gjykues, pas kryerjes së një analize logjike dhe të shqyrtimit e vlerësimit të panoramës së përgjithshme të përbërë nga fakte të provuara, rrethana bazike dhe periferike, dinamikave të ngjarjeve të njohura, deklarimeve, pohimeve e shpjegimeve të subjektit, raporteve dhe përgjigjeve të organeve ligjzbatuese, konstaton dhe arsyeton sa vijon e përshkruar në mënyrë të përmbledhur:

- i. Në mënyrë të përsëritur dhe të përditësuar edhe në fazën e fundit të hetimit administrativ, organet ligjzbatuese/ndihmëse janë shprehur se për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, nuk ekzistonin të dhëna se mund të kishte pasur apo të kishte ndonjë kontakt të papërshtatshëm apo të kishte dyshime se mund ishte përfshirë ndonjëherë në veprimtari të kundërligjshme.
- ii. Nuk rezultoi asnjë shqyrtim apo vendimmarrje e kryer nga znj. Rilinda Selimi mbi çështje gjyqësore në konflikt interesash apo me dyshime favorizimi, me palë persona fizikë, juridikë apo individë me të cilët ekzistoin marrëdhënie shoqërore, miqësore, civile, juridike apo të tjetër lloji, jo vetëm midis subjektit dhe palëve, por edhe midis këtyre të fundit dhe bashkëshortit të subjektit.
- iii. Ndonëse rezultoi e provuar ekzistenca e njohjes dhe miqësisë së hershme midis bashkëshortit të subjektit dhe shtetasit F. D. (dhe për këtë ai është ndëshkuar, duke i pësuar pasojat, *in primis*), në këtë rast, veç dyshimeve mbi një përfshirje të subjektit në kontekstin e një marrëdhënieje familjare të gjerë midis familjarëve të saj dhe të familjes së shtetasit F. D., nuk ka rezultuar asnjë provë apo *indicie* që mund të çonte përtej këtyre dyshimeve, lidhur me ekzistencën konkrete të kontakteve direkte midis subjektit dhe shtetasit F. D.
- iv. Ashtu siç është cituar edhe në vendimin e sipërpërmendur të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁷⁸, ka rezultuar se shtetasi F. D., vetëm në vitin 2018 është regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si i dyshuar për veprën penale të trafikimit të narkotikëve (ndonëse referencat e policisë së shtetit datonin prej vitit 2013). Në çdo rast, ky fakt e përjashton mundësinë e njohjes së kësaj rrethane përpara vitit 2018, nga subjekti dhe, rrjedhimisht, edhe përgjegjësinë e saj, në rast se do të kishte rezultuar se në mënyrë sporadike apo rastësore do të kishte pasur kontakte me shtetasin F. D., përpara regjistrimit të tij në regjistrin e njoftimeve të veprave penale.
- v. Më pas ka rezultuar se shtetasi F. D. është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, për të cilën ishte shkruar si i dyshuar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, më 19.1.2018.
- vi. Nëpërmjet përgjigjeve të dhëna, subjekti i rivlerësimit ka specifikuar dhe përkufizuar rrethanën faktike, të shprehur më herët si “marrëdhënie familjare” sipas së cilës bashkëshorti i saj, së bashku me babain dhe vëllain e tij, kishte pasur me shtetasin F. D. Pra, bëhej fjalë për një njohje miqësore dhe frekuentim midis personave të gjinisë mashkullore (siç mund të ndodhë shpesh dhe të konsiderohet e zakonshme), pa një përfshirje të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, vlen të qartësohet se në këtë kontekst, edhe nëse do të kishte pasur ndonjë kontakt midis shtetasit F. D. dhe subjektit, mes shumë familjarësh apo miqsh të tjerë, nuk mund të hipotezohej ekzistenca e kontakteve të tilla që, në kuptimin e pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, mund të krijonin kushtet

⁷⁸ F. 22, paragrafi 61.

- apo premisat e një influencimi përfshirë veprimtari të kundërligjshme të subjektit apo vënien e kësaj të fundit nën presion nga krimi i organizuar.
- vii. Nuk ka rezultuar e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer ndonjë udhëtim me ndonjë automjet apo në shoqërinë e shtetasit F. D., së paku pasi ky i fundit ishte regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, si i dyshuar për veprën penale të trafikimit të narkotikëve.
- viii. Nuk ka rezultuar e provuar, por as janë shprehur dyshime nga organet ligjzbatuese mbi ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm të subjektit me individë me precedentë penalë të cilësuar si të përfshirë në gamën e krimit të organizuar, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10191, datë 3.12.2009.
135. Në vijim dhe, për rrjedhojë të sa është konstatuar, përshkruar dhe arsyetuar më lart, trupi gjyqës mbërrin në konkluzionin se përgjatë hetimit administrativ të kryer në mënyrë të pavarur nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte që mund të çënojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, apo elementë të mjaftueshëm që mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

136. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLGJ –së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në:
- i. raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGj-ja, dërguar me shkresën nr. ***prot., datë 25.3.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.4.2019;
 - ii. informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;
 - iii. kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1 Analiza e aftësive profesionale e kryer nga KLGj-ja

137. Raporti i përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 2.4.2019, i përpiluar nga KLGj-ja për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:
- i. aftësitë profesionale;
 - ii. aftësitë organizative;
 - iii. etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
 - iv. aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
138. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.
139. Në përfundim të analizimit të akteve dhe të dhënave përkatëse nga KLGj-ja, veç të tjerash, ka konstatuar sa vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, me vendimin nr. ***, datë 4.6.2013, të ish-KLD-së, është vlerësuar “shumë mirë” për periudhën kohore 2005 – 2006, sipas tabelës “vlerësimi përfundimtar”; me vendimin nr. ***, datë 2.10.2015, të ish-KLD-së, është vlerësuar “shumë mirë” për periudhën kohore 2007 – 2009, sipas tabelës “vlerësimi përfundimtar”.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
- iii. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur Kolegji. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.
- iv. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, në periudhën e rivlerësimit, 4.11.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe ka deklaruar se për tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 3418 çështje dhe ka përfunduar 1336 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 954 çështje.
- v. Bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja e gjykimit për subjektin Rilinda Selimi është 600 çështje administrative në tre vite. Rezulton se gjyqtarja e ka tejkaluar këtë standard, duke përballuar volumin.
- vi. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Rilinda Selimi ka përfunduar gjithsej 1239 çështje gjyqësore, nga të cilat 886 çështje administrative dhe 353 çështje marrëdhënie pune.
- vii. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 2 ditë (afati më i shkurtër-dosja 3) dhe në 3 muaj e 13 ditë (afati më i gjatë- dosja 2). Ndër pesë dosjet e vëzhguara, 3 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm, ndërsa dy vendime brenda afatit ligjor. Vendimi që është arsyetuar me vonesën prej 3 muaj e 13 ditë, ka qenë çështje marrëdhënie pune, me tre kërkitime, me të cilin është disponuar me vendim themeli për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Lidhur me mosrespektimin e afateve të shqyrtimit gjyqësor apo të depozitimit të vendimeve përkatëse, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe të dhëna të gjera dhe të detajuara, ku në thelb është shprehur se kjo ka ndodhur për shkak të mbingarkesës, pasi numri i çështjeve ka qenë shumë më i lartë se mesatarja e parashikuar dhe kjo ka ndodhur për pasojë të mangësive në organikë – gjë që ishte një fakt i njohur edhe publikisht.
- viii. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, përgjithësisht është efektive në punë dhe nuk ka pasur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi për shkaqe të organizimit të trupit gjykues apo stafit administrativ.
- ix. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

- x. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Rilinda Selimi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

C/2 Rivlerësimi i aftësisë profesionale nga Komisioni

- 140. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj-së dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e rezultuara nga denoncimet e publikut, si dhe duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

Lidhur me verifikimet mbi konfliktin e mundshëm të interesave

- 141. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është pyetur nëse gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare ka shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse kanë qenë: persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lidhur nga çfarëdolloj marrëdhënie interesi, përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit si gjyqtare.
- 142. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 3.2.2020, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin provues, si dhe ka sqaruar se përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit si gjyqtare nuk ka shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse të kenë qenë persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lidhur nga çfarëdolloj marrëdhënie interesi. Ky deklaram ka gjetur mbështetje të plotë në përgjigjet e institucioneve gjyqësore të administruara.
- 143. Gjithashtu është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar tri çështje me palë ndërgjyqëse “Tirana Bank”, referuar përgjigjes së Gjykatës Administrative të Apelit, nga ku vihet në dukje se shqyrtimet gjyqësore nuk kanë qenë në asnjë rast në gjendje papajtueshmërie, sikurse normon neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.
- 144. Duke konsideruar faktin se marrëdhënia juridike midis familjarit të subjektit dhe “Tirana Bank” ka filluar më 10.5.2013 (sipas kontratës së datës 10.5.2013 për një shitje me rezervë) dhe ka përfunduar më 4.11.2014 me shlyerjen e kredisë dhe me çlirimin nga hipoteka të pasurisë objekt shitblerjeje (sipas përmbajtjes së deklaratës noteriale të “Tirana Bank”, të datës 6.11.2014), arrihet në konkluzionin se tre çështjet me palë “Tirana Bank”, të shqyrtuara (dhe për më tepër të vendosura duke rrëzuar kërkesat e paraqitura prej kësaj banke) nga trupi gjykues ku ishte pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, nuk mund të përbënin konflikt interesi për sa kohë – përtej vendimmarrjes kundër “Tirana Bank” – ato janë regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, janë shqyrtuar dhe janë vendosur shumë kohë (disa vite) më pas sesa marrëdhënia juridiko-civile në fjalë ishte shuar. Gjithashtu, në këtë kontest, vlen të theksohet se sipas subjektit, proceduara e shitjes së kësaj pasurie, nga banka në fjalë, ka qenë fillimisht e paraprirë nga njoftimet publike të bankës për paraqitje ofertash në lidhje me këtë pasuri, duke mos paracaktuar kështu ofertuesin më të mirë, i cili do të ishte edhe blerësi i pasurisë.
- 145. Për të gjitha palët e tjera të përmendura në pyetësin nr. 5, datë 3.2.2020, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin në të cilin nga: (i) Gjykata Administrative e Apelit; (ii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; (iv) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për funksionin e ushtruar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd; (v) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; si dhe (vi) shkresën nga

KL Gj-ja në lidhje me komandimet e mundshme, konfirmohet mungesa e shqyrtimit të çështjeve që mund të gjeneronin dyshime mbi ndonjë konflikt interesi.

146. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se znj. Rilinda Selimi, përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit si gjyqtare, nuk ka shqyrtuar çështje gjyqësore ku si palë ndërgjyqëse të kenë qenë persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, përdorim-dhënës, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lidhur me të nga çfarëdolloj marrëdhënie interesi.
147. Nëpërmjet pyetësorit nr. 7, Komisioni iu drejtua sërish subjektit të rivlerësimit, duke i kërkuar informacion nëse gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare ka/kishte shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse kanë qenë apo janë persona fizikë, persona juridikë, të lidhur në çfarëdolloj marrëdhënie interesi, konkretisht shoqëritë: shoqëritë tregtare “***” sh.p.k., “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion shkresën e datës 28.1.2020, e cila konfirmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë komanduar në asnjë detyrë tjetër përveç asaj të gjyqtares dhe nuk ka pasur asnjë vendim komandimi si ndihmës magjistrate apo deleguar për çështje në gjykim në gjykatat e tjera.
148. Subjekti, lidhur me çështjet e gjykuara gjatë ushtrimit të detyrës, gjithashtu, vuri në dispozicion edhe shkresën nr. ***prot., datë 13.8.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilën rezultoi se janë gjykuar në total pesë çështje nga subjekti i rivlerësimit si relatores/anëtare e trupës, nga të cilat katër me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe një me shoqërinë “***” sh.p.k. Në përfundim të shqyrtimit të vendimeve të sipërpërmendura, evidentohet se koha/periudha e shqyrtimit të çështjeve si anëtare/kryesuese në gjykimet e sipërpërmendura ka qenë përtej/jashtë periudhës së marrëdhënies së qirasë midis vjehrrit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërive tregtare “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k.
149. Në përfundim të sa më sipër, lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesave, qoftë edhe në dukje, Komisioni, pasi ka trajtuar rastet e mësipërme, në kuadër të detyrimit të subjektit të rivlerësimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 9367/2005, për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në referencë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, arriti në përfundimin se, për sa kohë marrëdhënia e qirasë midis babait të bashkëshortit të subjektit rivlerësimit dhe shoqërive tregtare ka përfunduar shumë kohë më parë nga pjesëmarrja e saj në trupin gjykues, si dhe për sa kohë nuk provohet se ka gjykuar çështje gjyqësore në kundërshtim me dispozitat ligjore të neneve 72-73 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka provuar dhe shpjeguar bindshëm se nuk ka gjykuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit.

Denoncimet nga publiku

150. Në Komision – bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 – për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, janë paraqitur nga publiku 18 denoncime⁷⁹, ndër të cilët katër janë denoncime shitesë, të paraqitura në vazhdim të denoncimeve të mëparshme, të cilët janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse, si dhe dy fakte/rrethana të bëra publike nga mediat. Në vijim të sa më lartë dhe bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar disa dosje gjyqësore në funksion të rivlerësimit të aspektit profesional të subjektit të rivlerësimit.

⁷⁹ Në datën 11.12.2020 nga sektori i denoncimeve është përcjellë denoncimi i shtetasit V. L., përmbajtja thelbësore e tij është trajtuar në rezultatet e hetimit në f. 81 me nr. 17, për sa kohë rrethana ishte e njohur për trupën.

151. Komisioni, në vijim të shqyrtimit të denoncimeve që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se në përmbajtjen e pjesës më të madhe të tyre nuk janë evidentuar *indicie* apo elementë konkretë që mund të çonin në ndonjë shkelje procedurale apo cenim të të drejtave të palëve nga subjekti i rivlerësimit.
152. Ndërsa lidhur me disa prej denoncimeve janë kryer hetime të thelluara, duke administruar dosje hetimore dhe/ose gjyqësore, vendime specifike, si dhe procesverbale të seancave gjyqësore që ndërthureshin me referencat e denoncimeve në fjalë, nga analizimi i të cilave ka rezultuar sa vijon:
1. Lidhur me denoncimin nr. *** prot., datë 28.5.2019, të shtetasit H. R.
153. Denoncuesi i sipërcituar ka akuzuar gjyqtaren Rilinda Selimi për dhënie të një vendimi të padrejtë dhe është konstatuar se ky shtetas kishte ngritur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: *“Anulimin e aktit certifikatë pronësie me nr. ***, si një akt absolutisht i pavlefshëm, detyrimin e ZVRPP-së Tiranë, të lëshojë certifiaktën e pronësisë për këtë pronësi të paditësit në 37 % të pjesës së vendimit të KKKP-së Tiranë”*.
154. Nga analiza e dokumentacionit përkatës ka rezultuar se shtetasi H. R., kishte depozituar një kërkesë për shtyrjen e seancës së datës 23.9.2013, të orës 11:00, të cilën e ka protokolluar në sekretarinë e gjykatës, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, po të datës 23.9.2013, ka pushuar gjykimin në fjalë, pasi ka konstatuar se as pala paditëse dhe as përfaqësuesi i tyre ligjor nuk ishin prezent.
155. Për një vlerësim më të thelluar të kësaj situate, Komisioni i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, nëpërmjet shkresës së datës 30.1.2020, duke kërkuar kopje të vendimit/dosjes në fjalë dhe pasi i ka analizuar ato ka kërkuar shpjegime edhe nga subjekti nëpërmjet njoftimit të rezultateve të hetimit administrativ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

156. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, lidhur me dinamikën e çështjes objekt i këtij denoncimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion mbështetës dhe shpjegime të detajuara, si vijon.
157. “Denoncimi i shtetasit H. R. është paraqitur në lidhje me vendimin nr. ***, datë 23.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e gjykimin të çështjes, dhënë prej meje si trup gjykues monokratik. Shtetasi H. R. është në cilësinë e paditësit. Padia e tij është ngritur bashkërisht me shtetasin Sh. R..
158. Sikurse e keni konstatuar, në seancën gjyqësore të datës 23.9.2013, as paditësit dhe as përfaqësuesi i tyre ligjor av. Sh. B. nuk janë paraqitur. Vendimi për pushimin e gjykimin të çështjes është bazuar në parashikimin e nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile “Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve”, Pika 1: *“Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimin”*.⁸⁰
159. Shtetasi H. R. ka paraqitur ankim me pretendimin se vendimi është dhënë në kundërshtim me këtë dispozitë dhe është i padrejtë me arsyen se ka depozituar një kërkesë për shtyrjen e seancës së datës 23.9.2013, të orës 11:00, të cilën e ka protokolluar në sekretarinë e

⁸⁰ Vendimi i pushimit të gjykimin të një çështjeje është vendim jo përfundimtar me të cilin gjykata i jep fund procesit gjyqësor pa e zgjidhur çështjen në themel (neni 127 i Kodit të Procedurës Civile). Efektet juridike të vendimit të pushimit të gjykimin janë parashikuar në nenin 300 të po këtij Kodi, sipas të cilit vendimi i pushimit të gjykimin: (i) *“... nuk shuan padinë”*, paditësi, nëse e drejta e pretenduar prej tij nuk është parashikuar, mund të ngrejë përsëri të njëjtën padi; (ii) *“... sjell si pasojë anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe vendimet që jepen gjatë gjykimin”*; (iii) *“... por në rast se paditësi ngre përsëri të njëjtën padi, provat e mbledhura në gjykimin e pushuar mund të merren parasysh në gjykimin e kësaj padie, në qoftë se për marrjen rishitas të tyre ka vështirësi ose pengesa të pakapërcyeshme”*.

gjykatës. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 4.2.2015, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 23.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues”.

160. Në dhënien e shpjegimeve e çmoj të nevojshme të citoj përmbajtjen e nenit 175 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë përcakton se: *“Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër”*.
161. Në përputhje me këtë dispozitë, me çeljen e seancës gjyqësore të datës 23.9.2013 është verifikuar paraqitja e palëve dhe është konstatuar fakti se as pala paditëse dhe as përfaqësuesi i tyre ligjor nuk ishin paraqitur.
162. Lidhur me dijeninë për zhvillimin e seancës së datës 23.9.2013, vërehet nga Komisioni se:
 - (i) në datën 28.6.2013, ora 11:00, evidentohet në një fletë e titulluar “shënim” me përshkrimin: *“Seanca gjyqësore do të shtyhet për arsye se gjyqtarja është me raport mjekësor. Për këtë arsye seanca e ardhshme caktohet për në datën 23.9.2013, ora 10:00”*;
 - (ii) në këtë shënim, nuk specifikohet as prezenca dhe as mungesa e palëve në gjykim, si dhe nuk evidentohet procedura mbi njoftimin e palëve në mungesë, bazuar në parashikimet ligjore të Kodit të Procedurës Civile, për njoftimin e datës dhe orës së zhvillimit të seancës gjyqësore në datën 23.9.2013, pra, ora 11:00; (iii) për më tepër rezulton se në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 23.9.2013, ora 10:00, në paragrafin e dytë është cilësuar se: *“Nuk janë paraqitur paditësat S. R. dhe H. R. dhe se pas hetimit të shkaqeve të mosparaqitjes, rezulton se kanë dijeni nga shënimi i datës 28.6.2013, nga përfaqësuesi i tyre me prokurë av. Sh. B.”*.
163. Për sa evidentuar më sipër, shpjegoj se procesverbali gjyqësor, datë 23.9.2013, përmban të dhënat që janë verifikuar me çeljen e seancës gjyqësore të datës 23.9.2013. Procesverbali pasqyron, si vijon:
 - i. pala paditëse, përmes përfaqësuesit ligjor me prokurë të posaçme av. Sh. B., ka marrë dijeni për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, nga shënimi i mbajtur dhe nënshkruar nga sekretarja gjyqësore në datën 28.6.2013;
 - ii. janë paraqitur përfaqësuesit e palëve të paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me të dhënat përkatëse të personit përfaqësues dhe të aktit të përfaqësimit për secilën palë të paditur;
 - iii. janë paraqitur personat e tretë F. K., H. K., F. K. dhe K. K.;
 - iv. nuk janë paraqitur personat e tjerë të tretë cituar për secilin të dhënat dhe dijenia për secilin me letërthirjen e datës 28.6.2013 (Zyra e Përmbartimit Tiranë, A. K., A. L., A. L. dhe Rr. L.) ose me shpallje të datës 28.6.2013 (S. L., Zh. H. dhe F. K.);
 - v. në procesverbalin gjyqësor të seancës thuhet se: *“në lidhje me mosparaqitjen e palës paditëse, të paditurit dhe personat e tretë prezent u shprehën për pushimin e gjykimit”*.
164. Procesverbali gjyqësor është nënshkruar prej meje si dhe nga sekretarja gjyqësore, konform dispozitave procedurale. Nga verifikimi i prezencës së palëve, në mungesë dhe të paraqitura në seancë gjyqësore, ka rezultuar dijenia e palës paditëse sipas shënimit të datës 23.9.2013. Ky është shpjegimi më objektiv që arrij për sa i përket konstatimit nga

ana e Komisionit se “Në këtë shënim nuk specifikohet as prezenca dhe as mungesa e palëve në gjykim”.⁸¹

165. Theksoj se për seancat e planifikuara dhe që nuk zhvillohen kam ndjekur të njëjtën praktikë në veprimtarinë time gjyqësore sipas së cilës: sekretari gjyqësor dokumenton sipas porosisë së gjyqtarit shkakun e moszhvillimit të seancës. Sekretari, në aktin që mban, shënon palët dhe evidenton ato palë që janë paraqitur. Sekretari, në akt, dokumenton për secilën palë të pranishme dijeninë për seancën e radhës të caktuar me porosi të gjyqtarit, duke e ftuar të nënshkruajë procesverbalin “Për moszhvillimin e seancës”. Në rast të kundërt dhe në pamundësi, sekretari gjyqësor bën shënimin përkatës dhe kryen veprimet e njoftimit pa vonesë.
166. Për sa më sipër: (i) paraqitja e kërkesës për shtyrje të seancës; dhe (ii) mungesa në dosje e akteve të njoftimit për palën paditëse, konfirmojnë faktin e cituar në procesverbalin e seancës gjyqësore, datë 23.9.2012, se pala paditëse, përmes përfaqësuesit të tyre me prokurë av. Sh. B., ka marrë dijeni sipas veprimeve të kryera nga sekretarja gjyqësore për seancën e pazhvilluar të datës 28.6.2013, datë në të cilën për shkaqe shëndetësore nuk jam paraqitur në detyrë.
167. Lidhur me vlerësimin e shkakut të mosparaqitjes, pala paditëse, në dijeni të datës dhe orës së gjykimit, ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 23.9.2013, pasi në atë datë dhe në orën 11:00, përfaqësuesi i saj ndodhej në një tjetër gjykim në atë të Gjykatës së Elbasanit.
168. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se vendimi për pushimin e gjykimit të çështjes është i padrejtë, pasi gjykata e shkallës së parë ka konsideruar dhe ka pranuar si të vërtetë pretendimin e palës për depozitimin e kërkesës për shtyrjen e seancës gjyqësore, pasi e ka gjetur kërkesën për shtyrje të seancës së depozituar në dosjen gjyqësore dhe e ka konsideruar këtë vendim të pambështetur në ligjin procedural dhe në prova.
169. E shoh të arsyeshme që në shpjegimin tim të them se referuar kërkesave të ligjit procedural, paraqitja e kërkesës nuk mundet në çdo rast të argumentohet si rrethanë e vetëmjaftueshme që përlligj shtyrjen e seancës. Nëse rrethana që parashtrahet në kërkesën për shtyrjen e seancës nuk ka të bëjë me fakte të njohura/publike, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, kërkesa duhet të mbështetet në aktin përkatës provues të shkakut të ligjshëm që, si i tillë, justifikon mosparaqitjen e palës.
170. Në bazë të nenit 175 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa e palës paditëse për shtyrjen e seancës së datës 23.9.2013 nuk rezulton të provojë se motivohej “për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm”. Sikurse keni konstatuar, kërkuesi/pala paditëse bashkëlidhur kësaj kërkesë nuk ka paraqitur dokumentacionin që të provojë ekzistencën e një shkakut të ligjshëm (p.sh.: fletëthirrje /njoftime, raport mjekësor etj.).
171. Lidhur me përcaktimet e neneve 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile dhe zbatimin e tyre në dhënien e vendimit nr. ***, datë 23.9.2013, parashtrij se shkakut i mosparaqitjes së palës paditëse është vlerësuar i pajustificuar, për rrjedhojë, edhe mosparaqitja e palës paditëse është konsideruar pa shkaqe të arsyeshme. Në këto kushte është vendosur pushimi i gjykimit, si një nga rastet e parashikuara në ligj, në referim të germës “c”, të nenit 299, të këtij Kodi.

⁸¹ Nuk mundem të parashtrij si shpjegim dyshimin që natyrshëm ngre mbi përmbajtjen e aktit “shënim” të mbajtur në datën 23.9.2013, nga sekretarja gjyqësore, për shkak të mungesës sime. Një qasje e tillë do të mbetej veçse një hamendësim, në pamundësi absolute të provueshmërisë dhe që në këtë këndvështrim e vlerësoj jo të përshtatshëm në aspektin etik.

172. Në lidhje me përmbajtjen në vendim se: “*Në kushtet kur nuk rezulton që pranë gjykatës pala paditëse të ketë njoftuar paraprakisht mbi shkakun e mosparaqitjes së tij, gjykata çmon se gjykimi i çështjes nuk mund të vazhdojë dhe se konform neneve 179/1 dhe 299/c të Kodit të Procedurës Civile, duhet të vendoset pushimi i gjykimit të kësaj çështjeje*”, parashtrij se vendimi i jep përgjigje çështjes së bazueshmërisë së kërkesës procedurale të palës për shtyrjen e seancës, në referim të parashikimeve të neneve 175 dhe 179 të këtij Kodi. Kjo kërkesë gjendet në inventarin e dosjes gjyqësore që i përket këtij vendimi, cituar si rrethanë në arsyetimin e vendimit nr. ***, datë 4.2.2015, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.
173. Në përfundim, evidentoj se çështja që i përket pretendimeve të paditësit H. R. (dhe Sh. R.) është regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit⁸². Gjyqtari, relator i çështjes, me të cilin jam caktuar në përbërje të një trupi gjykues, ka konstatuar nga aktet e dosjes gjyqësore vendimin nr. ***, datë 23.9.2013. Me vënien në dijeni të këtyre rrethanave të çështjes nga gjyqtari relator, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile unë kam paraqitur kërkesë⁸³ për dorëheqje pranë kryetarit të gjykatës. Me vendimin nr. *** prot., datë 17.12.2019, të kryetarit të gjykatës, dorëheqja ime është pranuar.

Vlerësimi i trupit gjykues

174. Nisur nga përmbajtja e dokumenteve të administruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni, si dhe nga shpjegimet e zgjeruara të subjektit, trupi gjykues vlerëson se këto të fundit rezultojnë bindëse dhe se në këtë çështje gjyqësore nuk konstatohet ndonjë shkelje apo mangësi profesionale e znj. Rilinda Selimi.
2. Denoncimi nr. *** prot., datë 5.2.2020, i shtetases F. K.
175. Shtetasja F. K. denoncon subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, lidhur me vendimmarrjen e dhënë në datën 7.3.2019, duke kërkuar verifikimin e shkeljeve ligjore flagrante. Komisioni, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese e trupës që ka dhënë vendimin në fjalë, me të cilin është vendosur: “*Lënia në fuqi e vendimit nr. 523, datë 13.4.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë*”.
176. Nga sa më sipër, vendimet e gjykatave rezultojnë të kenë zgjidhur çështjen në themel. Kundër vendimit të sipërpërmendur ka rezultuar se është paraqitur një rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e tij. Pretendimet e denoncueses lidhen me themelin e gjykimit të çështjes dhe nuk janë konstatuar shkeje procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me dy fakte të njohura botërisht

3. Komisioni është vënë në dijeni të disa rrethanave faktike, të publikuara në datën 25.11.2020, në emisionin investigativ “Stop”, në televizionin Klan.
177. Nga përmbajtja e këtij materiali rezulton se denoncuesi I. M. pretendon se një vendim i Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, i përdorur në gjykatë, ishte i falsifikuar dhe se palët e paditura nuk kanë qenë prezente në këtë gjyq, nuk janë përfaqësuar me avokat, nuk kanë marrë asnjë njoftim dhe se vendimi ka marrë formë të prerë pa dijeninë e tyre. Gjithashtu, ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit, duhej që të kishte konstatuar falsifikimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të

⁸² Çështja me nr.*** regjistri themeltar, datë regjistrimi 24.10.2016.

⁸³ Kërkesa është e datës 10.12.2019.

Pronave, si dhe që ajo, në shkelje të procedurës përkatëse, ka marrë një vendim pa kryer njoftimet dhe pa prezencën e palëve në gjykim.

178. Në vijim të sa më lart, Komisioni iu drejtua menjëherë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën e datës 26.11.2020, për të vënë në dispozicion vendimin në fjalë, të datës 4.12.2012, kopjet e procesverbaleve dhe kopje të fletëthirrjeve të çështjes civile të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, të cilat më pas janë përcjellë dhe janë administruar nga Komisioni.
179. Lidhur me sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka shpjeguar si vijon.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

180. Parashtror fillimisht se denoncimi dhe pretendimet kanë të bëjnë me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 4.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili është dhënë prej meje si trup gjykues monokratik. Procesi gjyqësor është iniciuar me padinë e ngritur në datën 19.12.2011 nga shtetasi L. L., trashëgimtar ligjor i shtetasit A. L.⁸⁴.
- i. Referuar përshkrimit të mosmarrëveshjes në materialin e denoncuar e gjej të nevojshme fillimisht të referoj në faktet dhe rrethanat që konstatohen nga aktet e dosjes gjyqësore:
181. Me vendimin nr. ***, datë 24.5.2002, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë ka vendosur t'i njohë shtetasit A. L. (trashëgimlënësit të paditësit L. L.), pronësinë me sip. prej 14800 m², sipas planvendosjes bashkëngjitur këtij vendimi, e ndodhur në fshatin ***, të Komunës Kashar. Sipas pikës 2 të këtij vendimi “sipërfaqja që i takon sipas ligjeve në fuqi është 10.480 m², nga e cila 9.700 m² i kthehet si truall i lirë. Sipërfaqja prej 780 m², i njihet për kompensim me një nga mënyrat e përcaktuara nga ligji”.
182. Komisioni citon në pjesën hyrëse të vendimit se (ai) vendimi është dhënë pas shqyrtimit të kërkesës së trashëgimtarëve të shtetasit A. L. (me nr. *** akti) me objekt kthimin dhe kompensimin e pronës të ndodhur brenda vijave kufizuese të fshatit ***, të Komunës Kashar. Në dosjen gjyqësore është administruar ky vendim me planvendosjen pjesë përbërëse të tij, si dhe praktika e dosjes së KKKP-së që i përket këtij vendimi.
183. Në datën 25.9.2008, shtetasi L. L. ka depozituar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Tiranë (ZVRPP) kërkesën për regjistrimin e pronësisë për sipërfaqen e kthyer trashëgimtarëve të z. A. L., sipas vendimit nr. ***, datë 24.5.2002, të KKKP-së Tiranë. Në shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 24.10.2008, të ZVRPP-së Tiranë⁸⁵, citohet se për këtë regjistrim ka pasur një kërkesë të mëparshme me nr. ***, datë 8.11.2007, të paraqitur nga ky shtetas
184. Me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2008, ZVRPP-ja Tiranë bën me dije paditësin L. L. se pasuritë që kërkon të regjistrojë rezultojnë në proces regjistrimi fillestar (përkatësisht në fazën e afishimit të të dhënave të kartelave), në pronësi shtet dhe si prona të personave të tjerë private, të cilët e kanë përfutur me akte të marrjes së tokës në pronësi. Këta persona të cituar nga ZVRPP-ja Tiranë janë të paditurit: 1. G. M., 2. A. L., 3. S. M., 4. I. M.⁸⁶, 5. I. M., 6. R. M., 7. P. M., 8. B. M. dhe 9. T. M.
185. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2011, ZVRPP-ja Tiranë i kthen përgjigje z. L. L., paditësit, se duke qenë se vendimi nr. ***, datë 24.5.2002, i KKKP-së Tiranë nuk është i regjistruar, nuk mund të veprojë me regjistrimin e kufizimeve të veprimeve në kartelat e

⁸⁴ Sipas dëshmisë së trashëgimisë me vendimin nr. ***, datë 25.4.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸⁵ Administruar në dosje, f. 68 e inventarit.

⁸⁶ Shtetasi që paraqet pretendime në material.

pasurive të personave të tretë (të paditurve), sipas nenit 44 të ligjit nr. 7843/1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

186. Në datën 10.6.2009, paditësi paraqet kërkesë pranë Komisionit Vendor të Shqyrtimit të Ligjshmërisë së Titujve të Pronësisë për verifikimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi, dhënë në pronën e trashëgimlënësit të tij. Kërkesa është regjistruar me nr. *** prot. Këto të dhëna citohen në shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2011, të Prefektit Tiranë, pranë të cilit funksiononte ky komision, me të cilin i bëhet me dije z. L. L. se Komisioni: “... do t’i shqyrtojë këto tituj pronësie në tërësinë e tyre dhe do të vendosë sipas ligjit”.
187. Deri më 28.3.2012, referuar shkresës nr. *** prot., datë 28.3.2012, të Prefektit të Qarkut Tiranë, ky komision nuk kishte marrë një vendim. Në datën 19.12.2012, z. L. L., ngre padinë e gjykuar prej meje, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Paditësi ka kërkuar që gjykata: (i) të shfuqizojë pjesërisht aktet e marrjes së tokës në pronësi me të cilët të paditurit e sipërpërmendur kanë përfutur në pronësi atë tokë, të cilën paditësi kërkon të urdhërohet regjistrimi si pronë e kthyer me vendimin nr. ***, datë 24.5.2002, të KKKP-së Tiranë trashëgimtarëve të trashëgimlënësit A. L.; (ii) të detyrojë ZVRPP-në Tiranë të procedojë me regjistrimin e vendimit të KKKP-së, kërkuar prej tij duke fshirë veprimet e regjistrimit të pronës në emër të të paditurive M.. ZVRPP-ja Tiranë, Komuna Kashar Tiranë si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës janë thirrur gjithashtu me cilësinë e palës së paditur, ndërsa Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka qenë në cilësinë e personit të tretë.
188. Padia e paditësit konsiston në thelb në pretendimin se prona e njohur dhe e kthyer është shpërndarë me aktet e marrjes së tokës në pronësi, në kundërshtim me ligjin pasi ndodheshin brenda vijës kufizuese të fshatit Mazrek. Duke qenë brenda vijave kufizuese të qendrës së banuar, ato nuk janë objekt i veprimit të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ligjit nr. 8503, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”⁸⁷ dhe akteve nënligjore në zbatim.

ii. Lidhur me veprimet procedurale në proces dhe dhënien e vendimit

189. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se çdo veprim procedural i kryer në proces⁸⁸ përshkruhet hollësisht në procesverbalet e seancave përgatitore dhe ato gjyqësore, sikurse dhe arsyetimi i vendimeve përkatëse të ndërmjetme. Në dosje është dokumentuar çdo veprim procedural i kryer për njoftimin dhe legjitimitimin e palëve ndërgjyqëse. Palët e paditura institucione shtetërore, me marrjen dijeni kanë autorizuar përfaqësuesit përkatës pjesëmarrës në proces. Autorizimet janë të administruara në dosje, përshkruar në procesverbal dhe në vendimin përfundimtar. Gjithashtu, dokumentohen edhe njoftimet për Avokaturën e Shtetit⁸⁹.
190. Veprimet procedurale lidhur me njoftimet, si në fazën përgatitore të çështjes, kryer në zbatim të nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile, ashtu edhe në gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore, përshkruhen në procesverbal. Aktet e njoftimit janë administruar: letërthirrjet dhe shpallje (për të paditurin B. M.). Konstatohet se njoftimet për të paditurit Mici për pjesëmarrje në seancat përgatitore dhe gjyqësore janë dërguar rregullisht përmes ftuesit gjyqësor ose me shërbim postar në vendin e banimit, të treguar në padi: Mazrek, Komuna Kashar Tiranë. Veprimet e njoftimit janë kryer konform përcaktimeve të nenit

⁸⁷ Në nenin 2 të këtij ligji thuhet shprehimisht se: “përfshihen nga dhënia në pronësi tokat bujqësore që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndodhen brenda vijës kufizuese të qyteteve dhe fshatrave ose qendrave të banuara”. Në pikën 2.2 të të njëjtit nen parashikohet shprehimisht se: “Në pikat 1 dhe 2 nuk përfshihen familjet ose individët që i kanë fituar këto toka bujqësore si bashkëthemelues të ish-kooperativave bujqësore apo të ndërmarrjeve bujqësore”.

⁸⁸ Lidhur me njoftimet (letërthirrje dhe/ose shpallje), kërkesa të ndryshme të palëve pjesëmarrëse të natyrës procedurale, marrje të provave, caktim dhe betim ekspertit, detyra e lënë ekspertit, diskutim i aktekspertimit etj.

⁸⁹ Në përbushje të detyrimit të përcaktuar nga neni 79/a i Kodit të Procedurës Civile.

128 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Për të paditurin B. M., referuar letërthirjes/eve kthyer nga shërbimi postar me shënimin “larguar”, është proceduar me njoftim afishim shpallje, konform përcaktimeve të nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile.

iii. Lidhur me pretendimet se: “palët e paditura (M.) nuk kanë qenë prezent në këtë gjyq, nuk janë përfaqësuar me avokat, nuk kanë marrë fare njoftime”, nga aktet e dosjes gjyqësore konstatoj se:

191. Është i rremë pretendimi i z. I. M. në materialin denoncues se nuk është njoftuar dhe se, për rrjedhojë, nuk ka qenë prezent në gjykim. Konstatoj se ky person ka marrë pjesë në seancën e datës 17.1.2012, zhvilluar për këtë çështje, i identifikuar si mbajtës i letërnjoftimit ***, i pasqyruar ky fakt në procesverbalin e seancës. Konkretisht, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në seancën përgatitore të datës 17.1.2012 (seanca e parë) kanë qenë të pranishëm personalisht disa prej të paditurve M. dhe konkretisht: G. M.⁹⁰, I. M.⁹¹ (personi denoncues në material) dhe T. M.⁹². Paraqitja në seancë e këtyre të paditurve është rrjedhojë e njoftimit me letërthirjet përkatëse, komunikuar përmes shërbimit postar. Theksoj se këto letërthirje evidentohen me figurë⁹³ në materialin denoncues dhe për të cilat pretendohet se nuk janë të rregullta në nënshkrimet përkatëse që përmban secila⁹⁴. Por prania në seancë është fakt që rrëzon tërësisht pretendimin në materialin denoncues të transmetuar publikisht.
192. Në vijim, në këtë seancë rezulton se për të paditurin A. L. është paraqitur djali i tij, shtetasi S. L.⁹⁵. Njoftimi me letërthirje rezulton në të njëjtën mënyrë si për të paditurit e mësipërm, me shërbim postar, i plotësuar nga ftuesi dhe marrësi, dorëshkruar “A. L.”, si dhe përmban nënshkrim (firma). Për të paditurit ZVRPP-ja Tiranë, Komuna Kashar Tiranë, KVTP-ja pranë Prefektit të Qarkut Tiranë⁹⁶ janë paraqitur përfaqësuesit përkatës të tyre, të autorizuar. I padituri DAMT Qarku Tiranë dhe personi i tretë AKKP-ja Tiranë nuk janë paraqitur. Të paditurit I. M., R. M. dhe P. M.. nuk janë paraqitur. Letërthirjet e datës 20.12.2012 janë kthyer nga shërbimi postar me plotësimet përkatëse të marrjes dijeni në kolonën marrësi dhe ftuesi. Njoftimi është vlerësuar i rregullt, sipas përcaktimeve të nenit 128 e vijues në fuqi të Kodit të Procedurës Civile. Letërthirja për të paditurin S. M. është kthyer me shënimin e nëpunësit postar “refuzuar”. Ky shënim i nëpunësit zyrtar vlerësohet në bazë të nenit 132 të Kodit të Procedurës Civile se e bën njoftimin të quhet i kryer. Letërthirja për të paditurin B. M. është kthyer me shënimin e nëpunësit postar “larguar”. Për këtë të paditur janë marrë veprimet e njoftimit përmes shpalljes, afishuar një kopje në gjykatë (këndi i njoftimeve), kopja tjetër në vendin e fundit të ditur të vendbanimit.
193. Në seancën pasardhëse përgatitore të datës 31.1.2012, të paditurit G. M., I. M. dhe T. M. nuk janë paraqitur, me gjithë dijeninë e marrë si të pranishëm në seancën paraardhëse të datës 17.1.2012. Po kështu, i padituri A. L. nuk është paraqitur në seancë, me gjithë dijeninë e marrë nga djali i tij, S. L. Letërthirjet për të paditurit e tjerë M. rezultojnë të jenë kthyer me shënimin e ftuesit gjyqësor A. B. “refuzon firmën”. Për të paditurin B. M. është vlerësuar se nuk ka dijeni dhe sipas shënimit të ftuesit gjyqësor A. B.⁹⁷ është proceduar me njoftim afishim shpallje, konform nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile, sikurse sipërcituar. Në këtë seancë ka marrë pjesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit

⁹⁰ Citohet në procesverbal se deklaroi se është i papajisur me kartë identiteti.

⁹¹ Identifikuar me kartën e identitetit ***, pasqyruar në procesverbal.

⁹² Identifikuar me kartën e identitetit ***, pasqyruar në procesverbal.

⁹³ Edhe me koment se janë të pavlefshme.

⁹⁴ Në letërthirjet përkatëse të përpiluara në datën 20.12.2011 për seancën e datës 17.1.2012, në secilën prej tyre rezulton të plotësuar: Rubrika “Ftuesi”: D. M. dhe Rubrika “Marrësi”: me emër mbiemër të dorëshkruar, poshtë tij nënshkrimi (firma).

⁹⁵ Mbajtës i pasaportës biometrike ***, pasqyruar në procesverbal.

⁹⁶ Pushuar gjykimin ndaj këtij institucioni si i paditur, me kërkesë të paditësit në fazën përgatitore të çështjes.

⁹⁷ Shënim i ftuesit: “... sipas kushërinjve të B., ai është në Itali, refuzuan të firmosnin”.

DAMT pranë Këshillit të Qarkut Tiranë. Institucionet e tjera të paditura dhe AKKP-ja Tiranë (person i tretë) nuk është paraqitur. Avokatura e Shtetit gjithashtu, me gjithë dijeninë e marrë rregullisht, nuk është paraqitur. Në seancën e fundit përgatitore datë 20.2.2012 të paditurit M. nuk janë paraqitur. Letërthirrjet e datës 31.1.2012 për secilin i janë kthyer gjykatës nga shërbimi postar me shënimin “refuzuar”, plotësuar rubrika e ftuesit: D. M.. Për të paditurin B. M.. njoftimi është urdhëruar dhe realizuar përmes shpalljes. Palët ndërgjyqëse në seancën përgatitore kanë paraqitur pretendime e kërkesa dhe është disponuar për to me vendim me të cilin, në përfundim të fazës përgatitore, çështja ka kaluar për gjykim. Në përputhje me pikën 6 të këtij vendimi të ndërmjetëm, të paditurit dhe personi i tretë janë njoftuar me letërthirrje për seancën gjyqësore të datës 1.3.2012, ndërsa i padituri B. M. me afishim shpallje. Në seancën gjyqësore (seanca e parë) të datës 1.3.2012 të paditurit M. nuk janë paraqitur. Letërthirrjet e datës 21.2.2012 i janë kthyer gjykatës nga shërbimi postar për secilin me shënimin “refuzuar”, plotësuar rubrika e ftuesit: D. M.. Për të paditurin A. L. është urdhëruar përsëritja e njoftimit me letërthirrje, për të paditurin B. M. është urdhëruar njoftim me shpallje, për të paditurit e tjerë M. është urdhëruar përsëritja e njoftimit me letërthirrje. Në seancën pasardhëse të datës 29.3.2012, letërthirrjet e datës 1.3.2012, të dërguara me shërbimin postar për të paditurit M. janë kthyer me shënimin nga nëpunësi postar “refuzuar”. Ky shënim rezulton edhe sipas letërthirrjes dërguar të paditurit A. L. Për të paditurin B. L. është vlerësuar i kryer njoftimi me shpallje. Në këtë seancë gjyqësore është marrë vendimi për gjykimin në mungesë të të paditurve M. dhe A. L., për palët e paditura DAMT pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, ZVRPP-ja Tiranë, si dhe për personin e tretë AKKP-ja Tiranë. Vendimi për gjykimin në mungesë është bazuar në përcaktimet e nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, pika 2, për mosparaqitje në gjykim pa shkaqe të arsyeshme.

194. Në vijim të pretendimeve sa i takon zbatimit të normave procedurale, konstatoj nga aktet e dosjes gjyqësore se: në seancën gjyqësore të radhës, të datës 2.4.2012, është paraqitur kërkesë paraprake nga ana e përfaqësuesit të Komunës Kashar për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Kjo kërkesë e palës së paditur është paraqitur me arsyen se pretendimet e paditësit mbi (pa) ligjshmërinë e akteve të marrjes së tokës në pronësi të kundërshtuara me padi, i janë paraqitur edhe Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, pranë Prefektit të Qarkut Tiranë dhe për sa kohë nuk është shprehur ende ky organ kompetent, këto pretendime nuk mund të shqyrtohen nga gjykata. Ndërsa paditësi ka prapësuar me pretendimin se kërkesa për verifikimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi të të paditurve është depozituar pranë Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë që në vitin 2009 dhe ende ky komision nuk kishte marrë një vendim. Ai, sipas ligjit, për pretendimet e ngritura ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës.
195. Me vendimin e datës 2.4.2012, në analizë të kërkimeve në padi dhe objektit të mosmarrëveshjes, kërkesa e palës së paditur Komuna Kashar për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit është rrëzuar si e pabazuar në ligj. Ky vendim është marrë në vështrim të vendimit unifikues nr.1, datë 26.11.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁹⁸, të përcaktimeve të ligjit të posaçëm nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe vendimit nr. 29, datë 31.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese. Arsyetimi i këtij vendimi, i administruar në dosjen gjyqësore është në përputhje me praktikën gjyqësore në mosmarrëveshje të tilla, e

⁹⁸ “Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ), për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative të të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ”.

konfirmuar edhe pas dhënies së këtij vendimi⁹⁹ nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe, në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

196. Në dosjen gjyqësore rezultojnë veprime të kryera nga ana e administratës gjyqësore për komunikimin e vendimit të datës 2.4.2012 për rrëzimin e kërkesës për nxjerrje jashtë juridiksionit gjyqësor. Komunikimi i vendimit për të paditurin B. M. është bërë përmes shpalljes. Për palët e tjera, sipas dëftesave të komunikimit të vendimit rezultojnë se: për të paditurit G. M. dhe T. M. dëftesa e komunikimit rezultojnë e nënshkruar. Po kështu, për institucionet shtetërore ZVRPP Tiranë, AKKP Tiranë, DAMT Qarku Tiranë. Për të paditurit I. M., S. M., P. M., R. M., A. L. dhe I. M. – dëftesa e komunikimit rezultojnë e kthyer me rubrikën postare “refuzuar” (faqet 254 - 294 të inventarit të dosjes).
197. Në vijim të veprimeve procedurale të kryera, konform nenit 224/a të Kodit të Procedurës Civile, është caktuar eksperte e licensuar znj. E. S.¹⁰⁰ Për çështjet e shtruara për dhënie mendimi të specializuar të fushës, ekspertja ka realizuar aktekspertimin. Në lidhje me pretendimet për padijeninë e zhvillimit të procesit, evidentoj si rrethanë relevante faktin se aktekspertimi është kryer me verifikimin në vend të pronave të palëve në mosmarrëveshje dhe pas matjeve në terren¹⁰¹.
198. Në përfundim të sa më sipër, pretendimet në përmbajtje të materialit denoncues për shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor në gjykimin e çështjes, janë të pabazuara.
- iv.** Lidhur me pretendimin në materialin denoncues se “vendimi ka marrë formë të prerë pa dijeninë e tyre”
199. Evidentoj në shpjegim se pas dorëzimit fizikisht të dosjes gjyqësore nga sekretari gjyqësor i gjykatës që ka dhënë vendimin në k/sekretarinë e gjykatës, veprimet administrative për komunikimin e vendimit ndiqen nga punonjësit përkatës të ngarkuar me komunikimin e vendimeve. Unë si gjyqtare nuk ushtroj asnjë detyrë dhe kompetencë tjetër për çështjen, pas dorëzimit të vendimit/dosjes gjyqësore në kryesekretarinë e gjykatës. Gjithsesi, veprimet e komunikimit janë pjesë e akteve të dosjes gjyqësore që jua vë në dispozicion.
- v.** Lidhur me pretendimet për falsitetin e vendimit
200. Sipas materialit denoncues pretendohet se: “vendimi i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është falsifikuar” dhe se unë si gjyqtare e çështjes duhej që të kisha konstatuar falsifikimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.
201. Bazuar në aktet e gjykimit të çështjes, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara. Së pari, vlefshmëria e vendimit që pretendohet si i falsifikuar është konfirmuar zyrtarisht nga organi shtetëror kompetent Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me shkresat:
- i. shkresë nr. *** prot., datë 30.1.2007, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bashkëngjitur kartelën shoqëruese të praktikës së këtij vendimi;
- ii. shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2008, drejtuar paditësit L. L. për vënien në dispozicion të “një fotokopjeje të inventarit të dosjes nr. ***”, në emër të ish-

⁹⁹ Në vështrim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” nuk ka ndonjë dispozitë që të parashikojë në mënyrë të detyrueshme, pa ekuivoke rrugën administrative të ankimit ndaj këtyre vendimeve, si dhe modalitetet e ankimit, e cila do t’i paraprijë procedurës gjyqësore dhe as të shmangë aksesin e drejtpërdrejtë në gjykatë. Gjykata Kushtetuese thekson se ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” është në pajtim me Kushtetutën vetëm nëse ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e theksuara prej kësaj gjykate, pra ai nuk prek titujt e pronësisë të dhënë në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tyre, komisionet vendore janë vetëm konstatuese të pavlefshmërisë, këto komisione nuk mund të anulojnë apo shfuqizojnë titujt të pronësisë apo të urdhërojnë rregjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme.

¹⁰⁰ Ing. Gjeodetë, me licensë nr. TZ ***, si dhe vlerësuese e pasurive të paluajtshme me licensë nr. VP ***, referuar të dhënave të procesverbalit gjyqësor.

¹⁰¹ Shihni aktekspertimin, cituar edhe në vendimin përfundimtar.

pronarit A. L.”. Aktet e mësipërme dhe praktikat e dërguara janë administruar në dosje gjyqësore.

202. Vendimi nr. ***, datë 24.5.2002, i KKKP-së Tiranë i dërguar me shkresën e sipërcituar nr. *** prot., datë 18.9.2008, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Tiranë, përmban nënshkrimin e kryetarit dhe vulën e organit, si edhe emrat dhe mbiemrat e dorëshkuar të shtetasve L. M.; F. Sh. dhe Q. K., të cilët pasqyrohen në pjesën hyrëse të tij anëtarë të komisionit. Planvendosja e vendimit nr. ***, datë 24.5.2002, e cila sipas ligjit është pjesë përbërëse e tij¹⁰², përmban nënshkrimet e drejtuesve dhe vulat e përkatëse të: KKKP-së Qarku Tiranë, Komunës Kashar, kryeplakut të fshatit Mazrek, si dhe Përgjegjësit të Seksionit të Urbanistikës së Qarkut Tiranë, si dhe vulat përkatëse të këtyre institucioneve.
203. Së dyti, edhe në përmbajtjen e shkresës nr. ***prot., datë 24.10.2008, të ZVRPP-së Tiranë (shkresa e sipërcituar) citohet se kjo zyrë, në procedurën e ndjekur për kërkesën e z. L. L. për regjistrimin e vendimit nr. ***, datë 24.5.2002, i KKKP-së Tiranë, i ka kërkuar konfirmimin e këtij vendimi Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në këtë shkresë të ZVRPP-së citohet: “meqë gjatë kësaj kohe nuk është bërë i mundur evidentimi i praktikës suaj (pasi specialistit që e punoi i janë ndërprerë marrëdhëniet me zyrën) ne dërguam për konfirmim në AKKP vendimin nr. ***, datë 24.5.2002 dhe pasi erdhi ky konfirmim, filluam procedurat për shqyrtimin e dokumentacionit...”.
204. Së treti, në këtë proces gjyqësor, gjatë gjithë ecurisë së tij, duke përfshirë njoftimet dhe palët pjesëmarrëse, në asnjë rast nga palët institucione shtetërore nuk janë ngritur pretendime për vlefshmërinë e vendimit nr. ***, datë 24.5.2002, të KKKP-së Tiranë apo rrethana për falsitetin e tij. Referuar akteve të dosjes gjyqësore sipas të dhënave të evidentuara më sipër (pikat 1 dhe 2) rezulton se nuk ka pasur vend për ngritjen e dyshimeve mbi vlefshmërinë e vendimit sikurse pretendohet apo se vendimi të mos ishte përfundimtar, pra objekt i ndonjë shfuqizimi apo ndryshimi të mëvonshëm.
205. Në përfundim të sa më sipër, konstatoj se në shqyrtimin e çështjes gjykata ka qenë e formuar sipas ligjit, me një gjyqtar. Palët ndërgjyqëse janë njoftuar rregullisht duke i garantuar mundësinë e ushtrimit të të drejtave procedurale në zbatim të parimit të kontradiktoritetit. Është zbatuar detyrimi për njoftimin e Avokaturës së Shtetit. Palët kanë paraqitur kërkesa dhe pretendime, kanë paraqitur aktet provuese, të cilat janë lejuar dhe shqyrtuar si prova shkresore, në formën dhe procedurën e kërkuar me ligjin. Për hetimin e plotë të çështjes është proceduar me realizimin e aktekspertimit, nga ekspert i licensuar.
206. Vendimi përfundimtar paraqet faktet dhe rrethanat, pretendimet objekt mosmarrëveshje, kronologjinë e veprimeve në proces dhe vendimet e marra në ecurinë e tij. Ai përmban përfundimet e aktekspertimit, arsyet e vlerësimit mbi mosmarrëveshjen, konkluzionet e tërhequra, pjesën urdhëruese si dhe të drejtën e ankimit: brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të tij¹⁰³.

Vlerësimi i trupit gjykues

207. Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.11.2012 dhe të shpjegimeve e prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit në këtë çështje ka zbatuar me përpikmëri normat procedurale lidhur me njoftimin e palëve, në respektim të plotë të të drejtave të tyre. Subjekti, pasi ka

¹⁰² Në përmbajtjen e vendimit nr. ***, datë 24.5.2002 citohen disponimet e dhëna për sipërfaqet, sipas planvendosjes.

¹⁰³ Për thelbin e çështjes shihni për mosmarrëveshje të ngjashme vendimet: nr. ***, datë 6.3.2012 dhe nr. ***, datë 22.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

hetuar shkaqet e mosparaqitjes së palëve, në mbështetje të neneve 175 dhe 131 në lidhje me nenin 158 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur të shtyjë seancën/at, pikërisht për të rinjofitur palët në mungesë, sipas adresave të dhëna në padi, si dhe të kryejë njoftimin me shpallje sipas përcaktimeve ligjore. Për rrjedhojë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes në fjalë, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se pretendimet e denoncuesve për shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor rezultojnë të pabazuara në prova.

208. Në përfundim të analizimit të materialit dhe dinamikës së fakteve të denoncuar konstatohet se në shqyrtimin e çështjes, *de qua*, nga subjekti i rivlerësimit janë njoftuar rregullisht palët ndërgjyqëse (duke zbatuar procedurat ligjore lidhur me njoftimin e palëve në mungesë dhe me shpallje), duke u garantuar mundësinë e ushtrimit të të drejtave procedurale në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe nuk ka rezultuar ndonjë shkelje apo mangësi profesionale nga znj. Rilinda Selimi.

4. Nga informacionet mediatike, si dhe nga informacione të tjera, Komisioni ka marrë dijeni mbi disa fakte dhe rrethana të publikuara në *link*-un: <http://top-channel.tv>.

209. Në përmbajtje të këtij informacioni/komenti ka referenca lidhur me vendimin nr. 921, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse znj. Rilinda Selimi etj., dhe me palë të paditur shoqërinë “****”.

210. Komisioni, pasi administroi materialin përkatës nga gjykata e sipërcituar, ka konstatuar se me vendimin nr. ***, datë 13.2.2017, shtetasit R. S., L. S., J. S., D. S. dhe A. B., kanë paditur shoqërinë “****” s.p.a, me objekt: “shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror shkaktuar paditësave për shkak të mosekzekutimit nga i padituri, pa shkak ligjor dhe në mënyrë të padrejtë, të kontratës së transportit ajror”. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰⁴ ka vendosur: “Pranimin e padisë, detyrimin e shoqërisë “****”, dega Shqipëri të dëmshpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror në vlerën 30.000 euro për shkak të mospërmbushjes së kontratës së transportit ajror në favor të paditësave”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 29.6.2017, ka vendosur: “Prishjen e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate¹⁰⁵ me një tjetër trup gjykues, ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë regjistruar me nr. ***, me status – studim çështje.

211. Lidhur me këto fakte publike, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit që të paraqiste shpjegimet e veta për sa më lart dhe të shprehej mbi ekzistencën e mundshme të ndonjë konflikti interesash midis saj dhe gjyqtarit të çështjes në fjalë. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur dokumentacion mbështetës dhe ka shpjeguar, veç të tjerash, si vijon.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

212. “[...] Në lidhje me padinë sqaroj se mosmarrëveshja civile është midis meje, tre fëmijëve të mi dhe mbesës A. B. si palë paditëse dhe shoqërisë “****” si palë e paditur. Mosmarrëveshja ka të bëjë me ngjarjen e datës 27.3.2016, ku na është refuzuar udhëtimi për në Milano, Itali¹⁰⁶ nga shoqëria ajrore e paditur. Udhëtimi i ishte parapaguar shoqërisë ajrore “****” s.p.a. për nisjen datë 27.3.2016 dhe kthimin në Shqipëri më 2.4.2016. Unë isha e pajisur me pasaportë diplomatike si dhe prokurat për fëmijët e mitur

¹⁰⁴ Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2019 iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresat nr. *** prot., datë 19.12.2019 dhe nr. *** prot., datë 13.12.2019 vuri në dispozicion vendimin nr. *** akti, nr. ***, datë 13.2.2017 të gjyqtarës A. G. (C.).

¹⁰⁵ Është kërkuar informacion mbi ecurinë e çështjes – nëse ka pasur një tjetër vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me këtë çështje.

¹⁰⁶ Te motra ime N. B.

udhëtarë. Edhe fëmijët ishin të pajisur me pasaporta biometrike të vlefshme për periudhën e udhëtimit (27.3.2016 – 2.4.2016) si dhe pas saj¹⁰⁷. Pra, ndryshe nga sa transmetohet në material, afati i vlefshmërisë së pasaportave të fëmijëve nuk ishte as 10 vjet dhe as nuk kishte skaduar/mbaruar. Për rrjedhojë, nuk është fare relevant njoftimi i dhënë nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë për rinovimin e pasaportave, siç thuhet në materialin e transmetuar, pasi njoftimi rregullonte një situatë krejt tjetër dhe specifike¹⁰⁸.

213. Sipas përfaqësuesit të shoqërisë ajrore në aeroport, ne nuk mund të udhëtonim pasi pasaportat e tre fëmijëve të mi nuk ishin të vlefshme edhe për një afat 3-mujor nga dita e nisjes. Për shkak të refuzimit të padrejtë dhe në kundërshtim me kontratën, kur shoqëria na kishte pajisur me biletë për udhëtimin e parapaguar për nisjen dhe kthimin dhe pasaportat ishin të vlefshme, paditëm shoqërinë ajrore për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar¹⁰⁹. Kompania ajrore mori atributet e autoritetit publik. Pasaportat ishin dokumente të vlefshme udhëtimi sipas rregullave të bëra me dije nga shoqëria në momentin e parapagimit. Sjellja e saj dhe qëndrimi me orë së bashku me katër fëmijët për marrjen e një shpjegimi të shumëkërkuar ishte e padrejtë¹¹⁰. Informacioni në material se kam përfituar 30.000 euro dëmshpërblim nga shoqëria ajrore është i pavërtetë. Një vit më parë nga transmetimi i kronikës televizive datë 11.6.2018, vendimi me nr. ***, datë 13.2.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pranimin e padisë ishte prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 29.6.2017. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “prishjen e vendimit nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues”. Ky fakt nuk paraqitet në përmbajtje të materialit duke qenë se vendimi i Gjykatës së Apelit në mënyrë thelbësore është në kontradiktë me rrethanat e shtrembëruara qëllimisht në përmbajtjen e materialit.
214. Ndaj vendimit nr. ***, datë 29.6.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë si palë paditëse kemi paraqitur rekurs, fakt të cilin e keni konstatuar. Çështja në Gjykatën e Lartë është regjistruar më 5.10.2017 dhe jam në pritje të gjykimin të saj si çdo qytetar. Edhe ky fakt dëshmon trajtimin abuziv të çështjes dhe pretendimet e pavërteta për përdorim të detyrës

¹⁰⁷ Pasaportat e fëmijëve të mi ishin të vlefshme deri më 15 dhe 16 maj 2016. Pasaporta e mbesës A. B. u lëshua më 9.3.2016, me procedurë të përshpejtuar për nevoja të këtij udhëtimi. Pasaporta ime ishte e vlefshme deri më 21.11.2021.

¹⁰⁸ Sipas njoftimeve të 6-mujorit të parë të vitit 2016 në linkun: <https://mb.gov.al/2016/04/14/1-korrik-2016-afati-i-pasaportave-biometrike-te-16-leshuar-ne-prill-2009-korrik-2010/> Ministria e Punëve të Brendshme rikujton se 1 korriku 2016 është afati i fundit i vlefshmërisë së pasaportave biometrike të lëshuara në periudhën prill 2009 – korrik 2010, me afat të pasaktë vlefshmërie për shtetasit shqiptar nën moshën 16 vjeç në momentin e aplikimit. MPB fton qytetarët që kanë hasur këtë problematikë, të aplikojnë sa më shpejt për pasaportat e reja duke shmangur radhët në ditët e verës, ku shtohet fluksi për shkak të ardhjes së emigrantëve... afati i vlefshmërisë së pasaportave për këtë kategori shtetasish është 5 vjet, në përputhje me standardet ndërkombëtare të dokumenteve të udhëtimit. Gjatë periudhës prill 2009 – korrik 2010, për shtetasit shqiptarë nën moshën 16 vjeç në momentin e aplikimit, janë lëshuar rreth 156.000 pasaporta me afat vlefshmërie jo të saktë (10 vjet), ndërkohë që duhet të ishin 5 vjet. Ministria e Punëve të Brendshme nënvizon se afati 5-vjeçar i vlefshmërisë së pasaportave biometrike për fëmijët 0 -16 vjeç është një standard i njohur ndërkombëtar, për shkak të ndryshimit në kohë të karakteristikave fizike të shtetasve të kësaj moshe... Me ardhjen e qeverisë së re në vjeshtën e vitit 2013, duke konstatuar problematikën, Ministria e Punëve të Brendshme mori masa për menaxhimin dhe zgjidhjen e saj. U propozua shtyrja e afatit të këtyre pasaportave me 1 vit, duke i bërë ato të vlefshme për 6 vjet, që t'u lihet kohë shtetasve për pajisjen me pasaportë të re biometrike. Propozimi i MPB-së u miratua në Kuvend në prill të vitit 2014.”

¹⁰⁹ Nga përmbajtja e padisë citoj: “Dëmi shkaktuar paditësave është rrjedhojë e një shkakut denigrues duke qenë se statusi i tyre u njehsua nga i padituri me atë të personave të padëshiruar, INAD/Deportiv etj., lëvizja jashtë shtetit e të cilëve kufizohet sipas përcaktimeve të normave në fuqi nga organet kompetente shtetërore, gjykata apo autoritetet policore. Nuk mundet që një kompani private ajrore të mos përmbushë detyrimet e saj për një shkak që përbën në fakt një masë administrative, kufizim i të drejtës për lëvizje drejt vendeve Schengen i shtetasit i pajisur me pasaportë brenda afatit të vlefshmërisë së saj. Nuk është në tagrin e kësaj kompanie të kryejë kontrollin e vlefshmërisë së pasaportave gjatë fazës Check in, kompetencë funksionale e punonjësve të policisë së kufirit gjatë procedurës së mevonshme të kontrollit të pasaportave. I padituri nuk mundet asesi të mos ekzekutojë kontratën duke paraqitur një arsye tej kushteve të kontratës së lidhur dhe aspak e parashtruar/kërkuar në momentin e lidhjes së saj. Sjellja e të paditurit bie nënesh me detyrat dhe përgjegjësitë e tij si transportues kundrejt paditësave të cilët njëkohësisht e kishin pajtuar duke paguar edhe kthimin me këtë kompani. Në fakt, i padituri nuk kreu veprimet as ndaj paditësve Rilinda Selimi dhe A. B., duke refuzuar zbatimin e kontratës me ta pa paraqitur asnjë lloj shkak. I padituri mban përgjegjësi edhe në lidhje me këtë fakt flagrant të shkeljes së kontratës kur asnjë kontestim në check in nuk është paraqitur në lidhje me këta paditës i padituri shkeli parimet e sjelljes së palëve në detyrimet kontraktore sipas kërkesave të arsyes dhe mirëbesimit.”

¹¹⁰ Bazuar në nenin 467/ë të Kodit të Procedurës Civile: “Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:(ë) lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë.”

publike në aspekte të gjykimit për qëllime të interesit privat, sikurse paraqitet në materialin e transmetuar nga Top Channel. Theksoj se unë, edhe pse cilësohem në materialin e transmetuar nga Top Channel se përdor pozitën si gjyqtare e Gjykatës Administrative të Apelit, po kështu edhe për bashkëshortin tim, në atë kohë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, nuk kam akoma deri më sot për mosmarrëveshjen e përfolur në transmetimin televiziv një vendim gjyqësor që ka përfunduar fazën e parë të gjykimit. Kjo gjendje ekziston edhe pse, sipas përmbajtjes së materialit, paraqiten rrethana abuzive për trajtimin e çështjes nga gjykata. Faktet dhe rrethanat lidhur me çështjen, si dhe trajtimi i saj dëshmojnë për ndjekjen e një rruge ligjore nga ana ime për të rivendosur të drejta kundrejt palës tjetër dhe për të cilën jam ende në pritje të vendimmarjes së gjykatës [...].

215. “Lidhur me znj. A. G., gjyqtarja e cila ka dhënë vendimin nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ju bëj me dije se unë nuk kam pasur dhe as kam marrëdhënie familjare/shoqërore apo të çfarëdolloji me të dhe nuk i njoh familjarët e saj. Deri në datën 1.11.2013 që kam qenë me detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kam qenë e angazhuar me dy gjyqtarë të tjerë në rast gjykimi të çështjeve me tre gjyqtarë. Po ashtu, nuk kam pasur qoftë edhe një gjykim ku unë dhe gjyqtare Ariana Gunbardhi të kemi gjykuar së bashku. Duke mos pasur asnjë lloj njohjeje apo marrëdhënie me të nuk kam se si të kem konflikt interesi”.

Vlerësimi i trupit gjykues

216. Duke konsideruar përmbajtjen e dokumentacionit të administruar dhe të shpjegimeve të subjektit lidhur me këtë pikë, fillimisht trupi gjykues qartëson faktin se nuk hyn në kompetencat e tij vlerësimi i bazueshmërisë apo jo të vendimit nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për më tepër që kjo çështje rezulton të jetë ende në gjykim, *sub judice*, po në të njëjtën gjykatë dhe prishja e vendimit, *de quo*, nga Gjykata e Apelit Tiranë, duket se ka ardhur për rrethana procedurale (që lidhen me ekspertizën) dhe jo drejtpërdrejtë me masën e dëmshpërblimit, *quantum debeat*.
217. Në këto kushte, trupi gjykues, ndonëse ka hetuar dhe analizuar këtë situatë në kuadër të një hetimi administrativ sa më të thelluar e gjithëpërfshirës – duke mos mundur të vlerësojë themelin e çështjes (bazueshmërinë e padisë civile dhe termat sasiorë), nuk gjen ndonjë rrethanë, fakt apo veprim ose mosveprim të subjektit që mund të krijojë lidhjen shkak-pasojë të sa është shprehur më sipër me kristalizimin e ndonjë përgjegjësie të znj. Rilinda Selimi, për sa kohë e drejta për të paraqitur një padi civile, kur dikush ndjehet i dëmtuar, nuk mund t’i mohohet askujt.
218. Gjithsesi, mund të ngriheshin dyshime dhe do të duhej të vlerësohej më në detaj kjo situatë, nën këndvështrimin e etikës së subjektit, por vetëm nëse do të rezultonin elementë konkretë që do të mund të evidentonin ndonjë përfitim të paligjshëm, aq më tepër nëse ky rezultat do të ishte realizuar në funksion të një qëllimi të paracaktuar të subjektit dhe nëpërmjet një ndikimi të paligjshëm tek organi vendimmarrës. Por për sa kohë hipoteza e një lidhjeje shkak-pasojë mbetet në nivel aludimi, imagjinimi apo qoftë edhe dyshimi dhe, për më tepër, që as nuk është konkretizuar efekti final (në sensin që subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj ende nuk kanë përfituar/marrë ndonjë dëmshpërblim nga shoqëria e paditur), ajo nuk mund të cenojë etikën e subjektit të rivlerësimit.
219. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLGj-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit – problematikat që kanë rezultuar lidhur me afatet e përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore, nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale, për më

tepër kur ato shpjegohen bindshëm nga subjekti dhe justifikohen nga situata e organikës, *de facto*, të paplotë në institucionin ku ajo kryen funksionin e gjyqtares.

220. Për rrjedhojë, në konkluzion, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërpërshkruara, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore përkatëse.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, trupi gjykues arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 14.12.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka